12—15
Hyrje
Introduction
Merve Elveren, Erëmirë Krasniqi

16—27
Shkundja e patriarkatit në shtetndërtimin neoliberal në Kosovë
Disrupting Patriarchy in Neoliberal Statebuilding in Kosovo
Vjosa Musliu

28—43
Erëmirë Krasniqi në bashkëbisedim me Fitore Isufi-Kojën
Erëmirë Krasniqi in conversation with Fitore Isufi-Koja

44—55
Zanafilla dhe amplifikimi i përfytyrimit politik kombëtar në Turqi
Genesis and Amplification of the National Political Imaginary in Turkey
Onur Yıldız

56—75
Merve Elveren në bashkëbisedim me Hale Tenger
Merve Elveren in conversation with Hale Tenger

76—87
Lidhur me projektet
Relating to Projects
Sezgin Boynik

88—103
Erëmirë Krasniqi në bashkëbisedim me Nurhan Qehajën
Erëmirë Krasniqi in conversation with Nurhan Qehaja

104—111
Histori e dendur: përballja me trashëgimitë e kombit
Overwhelming History: Tackling the Legacies of the Nation
Lara Fresko-Madra

112—131
Merve Elveren në bashkëbisedim me Esra Ersen
Merve Elveren in conversation with Esra Ersen

132—133
Indeksi
Index

134—137
Shënime biografike
Biographical notes

138
Kolofoni
Colophon

12—15
Hyrje
Introduction
Merve Elveren, Erëmirë Krasniqi

16—27
Shkundja e patriarkatit në shtetndërtimin neoliberal në Kosovë
Disrupting Patriarchy in Neoliberal Statebuilding in Kosovo
Vjosa Musliu

28—43
Erëmirë Krasniqi në bashkëbisedim me Fitore Isufi-Kojën
Erëmirë Krasniqi in conversation with Fitore Isufi-Koja

44—55
Zanafilla dhe amplifikimi i përfytyrimit politik kombëtar në Turqi
Genesis and Amplification of the National Political Imaginary in Turkey
Onur Yıldız

56—75
Merve Elveren në bashkëbisedim me Hale Tenger
Merve Elveren in conversation with Hale Tenger

76—87
Lidhur me projektet
Relating to Projects
Sezgin Boynik

88—103
Erëmirë Krasniqi në bashkëbisedim me Nurhan Qehajën
Erëmirë Krasniqi in conversation with Nurhan Qehaja

104—111
Histori e dendur: përballja me trashëgimitë e kombit
Overwhelming History: Tackling the Legacies of the Nation
Lara Fresko-Madra

112—131
Merve Elveren në bashkëbisedim me Esra Ersen
Merve Elveren in conversation with Esra Ersen

132—133
Indeksi
Index

134—137
Shënime biografike
Biographical notes

138
Kolofoni
Colophon

Hyrje

Merve Elveren dhe Erëmirë Krasniqi

Grusht shteti ushtarak i 12 shtatorit 1980 dhe regjimi i juntës që pasoi për tre vjet shtypi të gjithë mekanizmat e opozitës dhe rezistencës në vend, gjykoi qindra mijëra njerëz me dënim me vdekje, arrestoi, torturoi dhe kontrolloi plotësisht kujtesën kolektive. Ndërkohë, kalimi i qeverisë në neoliberalizëm u thellua dhe u institucionalizua. Tregu po zgjerohej dhe kapitali po rritej në vend. Turqia hyri në vitet 1990 me një regjim mirë të planifikuar autoritar në jetën shoqërore dhe politike dhe liberalizim të plotë në konsum. Megjithatë, ky vetëbesim në rritje mori një kthesë të ashpër dhe u pasua me tre ngjarje të rëndësishme: fillimi i Luftës së Gjirit, fundi i Luftës së Ftohtë dhe globalizimi. Ridefinimi i strukturës së shtetit-komb dhe kërcënimi nga hegjemonia Perëndimore në rajon ndikuan në rritjen e nacionalizmit, një ideologji tashmë shumë e njohur në Turqi.
Në gjysmën e parë të viteve 1990, skena e re dhe gjithnjë në rritje e artit bashkëkohor në vend u bë platformë jetike për të mbajtur diskutime të vazhdueshme mbi mekanizmat e depolitizimit, shkeljet e të drejtave të njeriut, përpjekjet për të u përballur me të kaluarën dhe premtimin dhe kolapsin e procesit të demokratizimit.

Për të gjeneruar lexime krahasuese, por edhe një dialog feminist mes dy gjeografive të ndryshme, një linjë e ngjashme kërkimi do të ndiqet në kontekstin e Kosovës. Duke hedhur një vështrim më të afërt në dekadën e parë pas përfundimit të luftës së Kosovës më 1999, praktikat artistike që u shfaqën nuk ishin të ndara nga pyetjet mbi identitetin kombëtar, përkatësinë dhe gjininë. Vitet e pasluftës në Kosovë u shënuan nga tranzicione ekstreme nga një regjim shtypës në çlirim; nga socializmi i shkatërruar nga lufta në demokracinë liberale të tregut; nga lufta në paqe. Deri në shpalljen e pavarësisë në vitin 2008, mekanizma të ndryshëm të protektoratit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë projektuan imazhin, vlerat dhe qëndrimet e tyre. Bashkëpunimi ndërmjet organizatave lokale dhe atyre transnacionale nuk ishte gjithmonë një shkëmbim përvojash, por më tepër një imponim i fuqisë së butë. Qasja kryesore e integrimit gjinor të protektoratit në shumë aspekte miratoi parimet e feminizmit liberal dhe neglizhoi trashëgimitë e lëvizjeve feministe lokale. Në kontekstin e formimit të shtetit-komb, një brez i ri i grave artiste doli në pah duke përdorur media të ndryshme si mjete për të artikuluar subjekt pozicionin e tyre në hapësirën e riorganizuar politike të vendit. Krijimtaria e tyre është domethënëse dhe ofron njohuri kritike për një spektër marrëdhëniesh në procesin e ndërtimit të shtetit-komb dhe në përpjekjet lokale për barazi gjinore.

"Identiteti Kombëtar dhe Praktikat Feministe: Perspektiva nga Kosova dhe Turqia" përqendrohet rreth punëve të përzgjedhura nga katër artiste gra. Fitore Isufi-Koja dhe Nurhan Qehaja nga Kosova dhe Esra Ersen dhe Hale Tenger nga Turqia. Puna "Flamuri" (2005) nga Qehaja dhe "Japonia" (2006) nga Isufi, duke rimarrë korporalen, negociojnë politikat e trupit dhe identitetin kombëtar. "Unë Njoh Njerëz të Tillë II" (1992) nga Tenger dhe "Në Paraburgim" (1995) dhe trilogjia "Një Histori e Mundshme" (2013-2023) nga Ersen — si metaforikisht ashtu edhe simbolikisht — vënë në pyetje pasojat e diskursit të vazhdueshëm nacionalist që kishte qenë në ballë të propagandës dhe shkrimit zyrtar të historisë në Turqi. Në punën e Qehajës dhe Isufit trupi bëhet një hapësirë për të kundërshtuar esencializmat dhe përfytyrimet kombëtare dhe transnacionale, ndërsa në punën e Tenger dhe Ersen, humbja e kujtesës kolektive ndërton boshtin qendror. Tekstet e komisionuara nga Sezgin Boynik, Lara Fresko-Madra, Vjosa Musliu dhe Onur Yıldız zgjerojnë më tej referencat mbi kontekstet shoqërore dhe politike të Turqisë të viteve 1990 dhe Kosovës në fillimin e viteve 2000, dhe për më tepër eksplorojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet strukturës së shtetit-komb dhe hierarkive gjinore.

Introduction

Merve Elveren and Erëmirë Krasniqi

The military coup d'état of September 12th, 1980 and the junta regime that followed for three years suppressed all mechanisms of opposition and resistance in Turkey, tried hundreds of thousands of people under the death penalty, arrested, tortured and fully controlled collective memory. Meanwhile, the government's transition to neoliberalism deepened and became institutionalized. The market was flourishing and capital generously flowed into the country. Turkey entered the 1990s with a planned authoritarian regime in social and political life and full liberalization in consumption. Yet this blooming self-confidence took a sharp turn with three major shifts: the start of the Gulf War, the end of the Cold War, and the rise of globalization. The redefinition of the nation-state structure and the threat of Western hegemony in the region led to a rise in nationalism, an ideology already well-known in Turkey. In the first half of the 1990s, the country's newly growing contemporary art scene became a vital outlet for holding ongoing discussions on the mechanisms of depoliticization, human rights violations, attempts to deal with the past, and the promise and collapse of the democratization process.

To generate comparative readings, but also a feminist dialogue between two different geographies, this publication pursues a similar line of inquiry in the context of Kosovo. Taking a closer look at the first decade after the end of the 1999 Kosovo War, the art practices that emerged were not separated from questions of national identity, belonging, and gender. The postwar years in Kosovo were marked by extreme transitions from an oppressive regime to liberation; from war-devastated socialism to liberal market democracy; from war to peace. Up until Kosovo's declaration of Independence in 2008, various mechanisms of the United Nations protectorate in Kosovo projected their own image, values, and attitudes. Cooperation between local and transnational organizations was not always an exchange of experiences, but rather an imposition of soft power. The gender mainstreaming approach of the protectorate in many respects adopted principles of liberal feminism and neglected the legacies of local grassroot feminist movements. In the context of nation-state formation, a new generation of women artists came to the fore using different media as means to articulate their subject position in the country's reordered political space. Their works are significant and provide critical insights into a spectrum of relations in the process of constructing the nation-state and into the local struggles for gender equality.

National Identity and Feminist Praxis: Perspectives from Kosovo and Turkey centers around selected works by four women artists. Fitore Isufi-Koja and Nurhan Qehaja from Kosovo and Esra Ersen and Hale Tenger from Turkey. The works *The Flag* (2005) by Qehaja and *Japan* (2006) by Isufi, by reclaiming corporeality, negotiate body politics and national identity. Tenger's *I Know People Like This II* (1992) and Ersen's *Under Custody* (1995) and *A Possible History* trilogy of works (2013-2023) — both metaphorically and symbolically — question the consequences of the ongoing nationalistic discourse that had been forefronted by propaganda and official history writing in Turkey. In the works of Qehaja and Isufi the body becomes a site to counter essentialisms and national and transnational imaginaries, whereas in the works of Tenger and Ersen, loss of collective memory constructs the central axis. Commissioned texts by Sezgin Boynik, Lara Fresko-Madra, Vjosa Musliu and Onur Yıldız further open up the social and political contexts of Turkey in the 1990s and Kosovo in the early 2000s, additionally exploring the complex relationship between the nation-state structure and gender hierarchies.

Shkundja e patriarkatit në shtetndërtimin neoliberal në Kosovë

Vjosa Musliu

Ky artikull lexon përafër dy punë artistike të Nurhan Qehajës "Flamuri" (2005) dhe Fitore Isufi-Kojës "Japonia" (2006) në sfondin e ristrukturimit themelor politik, ekonomik dhe shoqëror në Kosovën e pasluftës. Unë argumentoj se të dyja punët — veçmas dhe së bashku — shqyrtojnë shtetndërtimin neoliberal në Kosovë pas luftës së vitit 1999, duke shpërfaqur strukturat qenësore patriarkale që kanë mbetur të paprekura në këtë proces. Para se të diskutoj këto punë në vetvete, fillimisht ofroj një ilustrim të shkurtër rreth ristrukturimit neoliberal të Kosovës që nga viti 1999. Përqendrohem në mënyrën se si ky proces kryesisht u (vetë)pozicionua si një 'fletë e pastërt' që shpesh shpërfillte trashëgiminë lokale në shtetndërtim dhe mënjanoi, nëse jo plotësisht injoroi, trashëgimitë e mëparshme feministe. Në fund, reflektoj se si të dyja punët e Qehajës dhe Isufit ndërhyjnë dhe dekonstruktojnë patriarkatin e ngulitur në proceset e shtetndërtimit që legjitimohen përmes evropianizimit.

Pas një lufte brutale nga ushtria e Serbisë kundër shqiptarëve të Kosovës në fund të viteve 1990, Kosova iu nënshtrua të gjithë spektrit të intervencionimit liberal, duke përfshirë: sulmet ajrore të NATO-s kundër Serbisë dhe Malit të Zi që i dhanë fund luftës (1999); vendosja e trupave tokësore të NATO-s në Kosovë (1999); një mision gjithëpërfshirës administrues i Kombeve të Bashkuara (1999-2008); dhe instalimi i një Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit (2009-në vazhdim). Përveç Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe OSBE-së, këto struktura dhe institucione kërkuan të krijonin një shtet në Kosovë — një Kosovë evropiane me institucione politike dhe ekonomike neoliberale — të bazuar në "standardet më të larta ndërkombëtare"[1] sikur nga e para[2], sikur aty kurrë të mos kishte ekzistuar asnjë gjë.

Studiuesit kanë analizuar tendencën e strukturave liberale të intervencionimit për të instaluar "vitin zero" në shoqëritë e pasluftës dhe tendencën kokëfortë të tyre për të diktuar mënyrën e duhur të zhvillimit[3], mënyrën e duhur të angazhimit të shoqërisë civile[4], mënyrën e duhur të performimit të (barazisë) gjinore[5], formën e duhur të feminizmit, mënyrën e duhur për të bërë politikë *queer*[6], ndër të tjera. Njëkohësisht, të i mësosh "vendasit" për mënyrën e duhur e të bërit gjërat në politikë, art, ekonomi, veprim civil, historikisht ka shkuar paralelisht me diskreditimin dhe/ose shpërfilljen e sistemeve dhe trashëgimive të mëparshme.

Rasti i Kosovës, siç do të demonstroj në vijim, është një shembull thelbësor i kësaj logjike. Për shkak të statusit të saj të *papërfunduar* si një shtet plotësisht i pavarur, Kosova ka qenë konteksti dhe preteksti i përsosur për të testuar kufijtë e modeleve (neo)liberale. Në shumë mënyra, Kosova përjetoi *shok terapinë* e saj unike, pasi iu desh të transformohej, pothuajse brenda natës, nga lufta në jo-luftë, nga një sistem shtypës të ngjashëm me aparteidin në një demokraci; dhe nga një ekonomi gjysmë e kontrolluar në një ekonomi të hapur të tregut.

Ashtu si në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë, sipas sugjerimit të institucioneve të intervencionimit liberal, Kosova iu nënshtrua një forme të rëndë të privatizimit të ish-ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe shpronësimit të pronës që ishin të dëmshme për ekonominë e saj që përballej me vështirësi[7]. Përkundër provave të shumta të ndikimit katastrofik të këtyre politikave në terren, dhe përkundër dëshmive të shumta historike nga përvojat me privatizimin në vendet në Evropën Lindore dhe Amerikën Latine[8], këto politika neoliberale vazhduan të (vetë)legjitimohen dhe të materializohen jo vetëm si alternativë e vetme por edhe si superiore civilizuese.

Mikropolitika dhe politika e përditshme, si vlerat familjare, gjinia, seksualiteti, arti, prodhimi i dijes u

1
Musliu V. & Orbie J. (2014). "Deconstructing International Missions in Kosovo. What is in a name?". [Dekonstruktimi i Misioneve Ndërkombëtare në Kosovë. Çfarë ka në një emër?]. *European Foreign Affairs Review*. *19*(3): 411-428.

2
Musliu V. (2017). "Multi-ethnic democracy as an autoimmune practice: the case of international missions in Kosovo" [Demokracia multietnike si praktikë autoimune: rasti i misioneve ndërkombëtare në Kosovë]. *British Journal of Politics and International Relations. 19*(1): 188-201.

3
Rutazibwa, O. (2014). 'Studying Agaciro. Moving beyond Wilsonian Interventionist Knowledge Production on Rwanda' [Duke studiuar Agaciro. Përtej prodhimit të njohurive Intervencioniste Wilsoniane në Ruandë], *Journal of Intervention and Statebuilding*, *8*(4), 291-302.

4
Musliu V. (2021). *Europeanisation and Statebuilding as Everyday Practices: Performing Europe in the Western Balkans* [Evropianizimi dhe Shtetndërtimi si Praktika të Përditshme: Performimi i e Evropës në Ballkanin Perëndimor]. Routledge Studies in Intervention and Statebuilding. London: Routledge.

5
Musliu, V. & Mujika Chao, I. (2024). *Feminist Encounters in Statebuilding. Understanding the role of women in making the state in Kosovo* [Hasjet Feministe në Shtetndërtim. Kuptimi i rolit të gruas në bërjen e shtetit në Kosovë]. Routledge Studies in Intervention and Statebuilding. London: Routledge.

6
Rexhepi, P. (2017). *The Politics of (Post) Socialist Sexuality: American Foreign Policy in Bosnia and Kosovo* [Politika e Seksualitetit (Post) Socialist: Politika e Jashtme Amerikane në Bosnje dhe Kosovë]. Në: Jelača, D., Kolanović, M., Lugarić, D. (eds) *The Cultural Life of Capitalism in Yugoslavia* [Jeta Kulturore e Kapitalizmit në Jugosllavi]. Palgrave Macmillan, Cham.

7
Mustafa, A. (2020). Kosovo's social policy during self-management, UNMIK and independence: Persisting high inequality and social exclusion [Politika sociale e Kosovës gjatë vetëmenaxhimit, UNMIK-ut dhe pavarësisë: Pabarazia e lartë e vazhdueshme dhe përjashtimi social]. *International Journal of Social Welfare. 29*(1): 96-108.

8
Galeano, E. (1997). *Open Veins of Latin America: Five Centuries of the Pillage of a Continent* [Venat e Hapura të Amerikës Latine: Pesë Shekuj të Plaçkitjes së një Kontinenti]. Monthly Review Press.

përfshinë gjithashtu në sferën e re ideologjike e cila përpiqet (nëse nuk e ka bërë tashmë) të transformojë *personalitetin e ri kosovar*, shkurt për *personalitetin neoliberal-evropian kosovar*. *Personaliteti i ri neoliberal-evropian kosovar* është (vetë)shkëputur nga trashëgimia e tij socialiste jugosllave si dhe nga trashëgimia e sistemit paralel të viteve 1990. Në vend të kësaj, ai mendohet si një *tabula rasa* — ku idealet e demokracisë, ekonomisë së tregut të hapur, sipërmarrjes dhe konkurrencës janë të mishëruara dhe gradualisht të (vetë)internalizuara. Nisur nga Brown dhe Rottenberg, neoliberalizmi këtu kuptohet jo thjesht si një grup politikash ekonomike, por si një racionalitet politik mbizotërues që riformulon individët si kapital njerëzor dhe si rrjedhojë, agjentë të rritjes së kapitalit. Edhe pse si një rend ekonomik, neoliberalizmi mbështetet në punën e riprodhimit dhe kujdesit, ai gjithashtu rregullon që kjo punë e kujdesit dhe gjenerimi i të ashtuquajturit kapital njerëzor bie natyrshëm mbi supet e grave. Kështu, gruaja e re neoliberale-evropiane-moderne në Kosovë formohet si subjekti aspirues që vendos ekuilibrin ndërmjet ambicies së lartë, konkurrencës dhe suksesit të ngjashëm me sipërmarrjen nga njëra anë dhe kujdesit dhe riprodhimit familjar nga ana tjetër.

Në këtë interpretim të ri, nocione të tilla si *evropiane*, *liberale*, *neoliberale*, *moderne* ngatërrohen qëllimisht, përkthehen si të njëjta në thelb dhe si një progres natyror nga njëra në tjetrën në të njëjtën kohë. Erëmirë Krasniqi tregon se në këto kushte të reja, skena e artit bashkëkohor në Kosovë u bë agjente për të ofruar platformë për të diskutuar depolitizimin e shoqërisë, shkeljen e të drejtave të njeriut dhe normalizimin e patriarkatit, ndër të tjera[9].

> "E komunikuar kryesisht në publik përmes retorikës së evropianizimit, aspirata [e tillë] politike përmbledh një agjendë neoliberale të zhvillimit, ku përparimi kombëtar është i lidhur me vetë-realizimin ekonomik individual. Vlerat kulturore dhe premisat e neoliberalizmit si valorizimi i agjentëve të lirë, të racionalizuar dhe meritokratikë të abstrahuar nga strukturat ekzistuese socio-ekonomike u promovuan si cilësi të reja dhe të dëshirueshme. Në këtë aspekt, projekti i Kosovës si shtet evropian në bërje, nxiti një rikonfigurim të identiteteve kombëtare që i përmbahen agjendës së projektit të shtetndërtimit dhe evropianizimit[10]."

Paradoksalisht, siç do të demonstronte rasti i Kosovës, shtetndërtimi ndërkombëtar liberal nuk ka qenë progresiv sa i përket gjinisë[11] apo emancipues sa i përket seksualitetit[12]. Për shembull, në vitin 2005, aktivistet për të drejtat e grave dhe feministet varën një pankartë në rrethojën e ndërtesës së qeverisë së Kosovës në qendër të Prishtinës, duke sjellë vëmendjen te një mesazh i qartë: Rezoluta 1325 na garanton pjesëmarrjen në Negociata[13]. Negociatat e ndërmjetësuara nga OKB-ja ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit mes viteve 2006 dhe 2008 e cila synonte gjetjen e një zgjidhjeje për statusin përfundimtar të Kosovës – mezi përfshinte ndonjë grua dhe nuk njihte qëndrimet e grave për barazi gjinore. Duke vepruar kështu, ata nuk morën parasysh mbrojtjen e të drejtave dhe qëndrimet e grave përgjatë procesit, pavarësisht masave ndërkombëtare në rritje, siç është Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSC), e cila mbron pjesëmarrjen e barabartë të grave në të gjitha hapësirat vendim-marrëse në zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes (2000). Si rrjedhojë, ata gjithashtu (qëllimisht) nuk arritën të njohin aktivizmin dhe politikën e lëvizjeve të udhëhequra nga gratë dhe feministet para vitit 1999. Gjatë 25 viteve të fundit të shtetndërtimit (ndërkombëtar)

9
Krasniqi, E. (2022). 'Interrogating Exclusion: A Summary.' [Shqyrtimi i Përjashtimit: Një Përmbledhje] botuar në Secondary Archive, një platformë online e artisteve gra nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Edicioni i arkivit me artistet nga Kosova është kuruar nga Renea Begolli dhe Erëmirë Krasniqi. Linku: https://secondaryarchive.org/interrogating-exclusion-a-summary/

10
Berisha, R. (2024). The making of gender and the state in the newly independent Kosovo [Bërja e gjinisë dhe shtetit në Kosovën e re të pavarur]. Në: *Feminist Encounters in Statebuilding. Understanding the role of women in making the state in Kosovo* [Hasjet Feministe në Shtetndërtim. Kuptimi i rolit të gruas në bërjen e shtetit në Kosovë]. Red: Musliu & Mujika Chao.

11
Musliu, V. (2021). *Europeanisation and Statebuilding as Everyday Practices: Performing Europe in the Western Balkans* [Evropianizimi dhe Shtetndërtimi si Praktika të Përditshme: Performimi i e Evropës në Ballkanin Perëndimor]. Routledge Studies in Intervention and Statebuilding. London: Routledge.

12
Rexhepi, P. (2022). *White Enclosures Racial Capitalism and Coloniality along the Balkan Route* [Rrethojat e Bardha, Kapitalizmi Racial dhe Kolonialiteti përgjatë Rrugës Ballkanike]. Duke University Press.

13
Rrjeti i Grave të Kosovës. (2005). *Raporti vjetor i Rrjetit të Grave të Kosovës 2005. Prishtinë: Rrjeti i Grave të Kosovës.* https://womensnetwork.org/sq/publications/raporti-vjetor-i-rrggk-se-per-vitin-2005/

në Kosovë, praktikat e ristrukturimit (neo)liberal janë ndeshur vazhdimisht me akte rezistence nga lëvizjet e udhëhequra nga gratë dhe feministet në lidhje me politikën e ristrukturimit gjinor, ndikimit mjedisor dhe shoqëror të privatizimit, ndër çështje të tjera.

Paradoksi i një *tabula rasa*

Kosova ishte rajoni më i pazhvilluar në ish-Jugosllavi. Deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, më shumë se 80 për qind e popullsisë së Kosovës ishte analfabete dhe kjo përqindje ishte edhe më e lartë tek gratë dhe vajzat. Kjo pasqyrë duket edhe më e zymtë në art dhe kulturë. Galeria e parë në Kosovë u hap vetëm në vitin 1979 (Universiteti i Prishtinës u hap katër vjet më parë) me shumë artistë të asaj kohe që përfaqësonin ndikimet stilistike të skenave të artit në Jugosllavi[14] edhe pse ata u përpoqën të krijonin një estetikë të re, të diferencuar të tyren[15].

Dekada e viteve 1990 karakterizohet kryesisht nga i ashtuquajturi sistem paralel në Kosovë. 150 mijë njerëz u përjashtuan nga sektori publik dhe rreth 400 mijë studentë dhe nxënës u dëbuan nga shkollat publike. Të dëbuar nga të gjitha institucionet publike — mjekësore, arsimore, kulturore dhe ekonomike — shqiptarët që përbënin mbi 80 për qind të popullsisë së Kosovës në atë kohë, u vetëorganizuan në struktura paralele duke ruajtur shtresat burokratike, ligjore, sociale dhe ekonomike të një shteti përbrenda një shteti. Masat represive ishin edhe më të rënda për skenën artistike me galeritë e artit, teatrot dhe aktivitetet kulturore që u zhvendosën në kafene të zymta dhe nëpër perferi të qyteteve të Kosovës.

Për Maliqin[16], në sfondin e një aparteidi të instaluar, të rinjtë shqiptarë kosovarë e kthyen vështrimin kah skenat e artit Perëndimor dhe thellësisht u ndikuan nga qasjet e reja dhe kritike mbi artin modern. Ky rebelim artistik përkoi me zhvillimin e një sërë organizatash feministe dhe të udhëhequra nga gratë, të cilat u shfaqën dhe u zhvilluan në Kosovë gjatë kësaj periudhe duke trajtuar analfabetizmin e përhapur në mesin e grave dhe vajzave në zonat rurale[17]; lëvizjet studentore feministe[18]; si dhe lëvizjet *queer*[19]. Këto aktiviste feministe po luftonin për emancipimin e grave dhe vajzave brenda shoqërisë shqiptare, si dhe për emancipimin e subjektit shqiptar (gratë dhe burrat) si kundërpërgjigje ndaj masave represive të Beogradit.

Aktivizmi dhe vetëorganizimi i gjerë i kosovarëve nuk u shfaq në vakum. Në fakt, Kosova ka një histori të mobilizimit feminist që daton që nga periudha jugosllave. Shembuj të tillë përfshijnë llegalen[20], një lëvizje jo e dhunshme e rezistencës civile[21]. Këto grupime kanë dëshmuar se çlirimi dhe shtetformimi ishin forcat kryesore shtytëse pas lëvizjes dhe mbrojtja e të drejtave të grave ishte dytësore, edhe nëse aktivizmi i grave ishte i pranishëm përgjatë shumë viteve. Shumë gra aktiviste këmbëngulën në aktivizmin e tyre, duke qëndruar shpesh në kundërshtim me strukturat organizative të lëvizjes kombëtare[22]. Gratë dhe aktivistet feministe i përcaktuan të drejtat e tyre si parakusht thelbësor për një shoqëri progresive[23], duke konstruktuar rolin e gruas si figurë kyçe në proceset e demokratizimit në Kosovën e para pavarësisë. Me ndryshimet politike pas vitit 1989 dhe me revokimin e autonomisë së Kosovës, strategjitë e grave gradualisht u pikëtakuan me identitetin kombëtar dhe kauza e çlirimit kombëtar mbizotëroi mbi çështjet e klasës dhe gjinisë. Eventualisht, së bashku me luftërat që po ndodhin në rajon dhe me shpërbërjen e Jugosllavisë, lindi një feminizëm rajonal antimilitarist dhe pacifist. Ky feminizëm

14
Krasniqi, E. (2022). 'Interrogating Exclusion: A Summary.' [Shqyrtimi i Përjashtimit: Një Përmbledhje] botuar në Secondary Archive, një platformë online e artisteve gra nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Edicioni i arkivit me artistet nga Kosova është kuruar nga Renea Begolli dhe Erëmirë Krasniqi. Linku: https://secondaryarchive.org/interrogating-exclusion-a-summary/

15
Maliqi, Sh. (2021). "Arti në rezistencë". Shtëpia Botuese Koliqi.

16
Po aty.

17
Rogova, I. (2020). My take, your take: Women's rights in Kosovo, then and now [Mendimi im, mendimi juaj: Të drejtat e grave në Kosovë, atëherë dhe tani]. UN Women: eca.unwomen.org/en/news/stories/2019/10/your-take-my-take-womens-rights-in-kosovo-0

18
Hetemi, A. (2020). *Student Movements for the Republic of Kosovo. 1968, 1981 and 1997* [Lëvizjet Studentore për Republikën e Kosovës. 1968, 1981 dhe 1997]. Palgrave Macmillan.

19
Musliu, V. (2021). *Europeanisation and Statebuilding as Everyday Practices: Performing Europe in the Western Balkans* [Evropianizimi dhe Shtetndërtimi si Praktika të Përditshme: Performimi i e Evropës në Ballkanin Perëndimor]. Routledge Studies in Intervention and Statebuilding. London: Routledge.

20
Krasniqi, E. (2021). Same Goal, Different Paths, Different Class: Women's Feminist Political Engagements in Kosovo from the Mid-1970s until the Mid-1990s [I Njëjti Qëllim, Shtigje të Ndryshme, Klasa e Ndryshme: Angazhimet Politike Feministe të Grave në Kosovë nga Mesi i Viteve 1970 deri në Mesin e Viteve 1990]. *Comparative Southeast European Studies 69*(2-3): 313-334.

21
Krasniqi, V. (2011). *Feminism and nationalism* [Feminizmi dhe nacionalizmi]. *ProFemina (Summer/Autumn)*, 53– 58; *Schwandner- Sievers, Stephanie.* (2013). *The bequest of Ilegalja: Contested memories and moralities in contemporary Kosovo* [Amaneti i Ilegales: Kujtimet dhe moralet e kontestuara në Kosovën bashkëkohore]. *Nationalities Papers*, *41*(6), 953– 970.

22
Di Lellio, A. (2016). *Seeking justice for wartime sexual violence in Kosovo* [Kërkimi i drejtësisë për dhunën seksuale të kohës së luftës në Kosovë]. *East European Politics, Societies and Cultures*, *30*(3), 621– 643.

23
Vardari - Kesler, A. (2014). Between the Oda and statebuilding, collective action of women in post- war Kosovo's politics [Midis Odës dhe shtetndërtimit, veprimi kolektiv i grave në politikën e Kosovës pas luftës]. *Journal of Social Knowing*.

rajonal ndihmoi në ndërkombëtarizimin e kauzës feministe, së bashku me lëvizjet e solidaritetit në Kosovë[24].

Studimet që trajtojnë lëvizjet e grave përgjatë rindërtimit dhe paqendërtimit pas luftës janë përqendruar në atë se si elitat politike lokale dhe arkitektura ndërkombëtare e paqendërtimit dhe shtetndërtimit kanë injoruar dhe anashkaluar kontribute të tilla, dhe rrjedhimisht nuk i kanë përfshirë gratë dhe subjektet e tjera gjinore disidente në infrastrukturën, synimet dhe programet e tyre[25]. Në Kosovën e pasluftës, ky anashkalim në vazhdimësi është bërë i mundur përmes rrëfimit, arkivimit, historizimit dhe praktikave të komemorimit të shtetbërjes së Kosovës *përmes tytës së armës*, të mbajtur nga një subjekt mashkull[26]. Së dyti, anashkalimi i kësaj trashëgimie — edhe pse më së shumti i përhapur në shkencat sociale dhe shumë më pak në studimet kulturore dhe antropologji — i detyrohet shumë krijimit të *gruas neoliberale-evropiane kosovare*. Ngjashëm me krijimin e *personalitetit të ri neoliberal kosovar*, edhe krijimi i gruas neoliberale kosovare të pasluftës u bë i mundur përmes këtyre ristrukturimeve.

Për shembull, aktivizmi (feminist) — i bërë kryesisht falas dhe si akt rezistence para vitit 1999 — u bë me rregullore, i qeverisur dhe i organizuar si OJQ, ku puna dhe aktivitetet feministe do të vlerësoheshin sipas standardeve dhe kritereve të vlerësimit të zbatueshme ndërkombëtarisht. Në këtë ngërç të ri, aktivizmi (feminist) u shkëput nga parimet e tij emancipuese, revolucionare dhe abolicioniste dhe u kthye në feminizëm të domestikuar, ku fokusi ishte kryesisht në ndryshimin e ligjeve dhe politikave dhe miratimin e "të drejtave në letër", por jo duke kërkuar drejtësi strukturore[27]. Si të tilla, mjetet e reja që aktivistet (feministe) pritet të marrin në Kosovë janë ato që kërkojnë të rregullojnë 'diskriminimin' por jo të luftojë 'shtypjen'.

Lidhur me këtë, duke folur për shtresëzimet komplekse ideologjike dhe politikën kohore që i gjallërojnë nocionet e gruas së re kombëtare në Kosovë, Rozafa Berisha[28] pohon se "'gruaja e re kosovare' është ndërtuar rreth boshtit të shumëfishtë të identifikimit etnokombëtar, evropianizimit dhe neoliberalizmit, të gjitha këto që lidhen me të ardhmen e aspiruar politike të shtetit të Kosovës" (f. 224). Nita Luci[29] ka dëshmuar se kornizat nacionaliste në Kosovë — dhe si rrjedhojë ato shtetndërtuese — i konstruktojnë gratë kryesisht si subjekte politike gjinore dhe etnike. Pjesë e ristrukturimit të ri të ekonomisë politike është edhe ngatërrimi i neoliberalizmit me feminizmin, i cili sipas Rottenberg e thekson suksesin profesional dhe ekonomik, përderisa nuk ndikon negativisht në rolin e gruas në familje. Pedagogjia e gjinisë dhe feminizmit nën neoliberalizëm, edhe pse qartazi njeh pabarazinë gjinore, ajo mohon strukturat socio-ekonomike dhe kulturore që i japin formë jetës së grave në Kosovë (dhe vende tjera). Në të njëjtën kohë, këto pedagogji dhe politika të ristrukturimit, në vazhdimësi, edhe pse në mënyrë sporadike, hasën në rezistencën e aktivizmit të udhëhequr nga gratë dhe atij feminist në prodhimin e dijes, artit dhe kulturës ndër të tjera. Krasniqi shpjegon se në kontekstin e shtet-formimit, një brez i ri i grave artiste doli në sipërfaqe duke përdorur media të ndryshme si mënyrë për të artikuluar subjekt pozicionin e tyre në hapësirën e riorganizuar politike të vendit.

24
Luci, N. & Gusia, L. (2014). *Our Men Will Not Have Amnesia: Civil Engagement, Emancipation, and Transformations of the Gendered Public in Kosovo* [Burrat Tanë Nuk do të Kenë Amnezi: Angazhimi Civil, Emancipimi dhe Transformimi i Publikut Gjinor në Kosovë]. Në Sabrina P. Ramet, Albert Simkus & Ola Lishtaug (red.) *Civic and Uncivic Values in Kosova: Value Transformation, Education, and Media* [Vlerat Qytetare dhe Joqytetare në Kosovë: Transformimi i Vlerave, Arsimi dhe Media]. Central European University, 199–217.

25
Corrin, C. (2000). *Gender Audit of Reconstruction Programs in South Eastern Europe* [Auditimi Gjinor i Programeve të Rindërtimit në Evropën Juglindore]. *Urgent Action Fund & Women's Commision for Refugees and Children; Abdela, Lesley.* (2004). *Kosovo: Missed Opportunities, Lessons for the Future* [Kosova: Mundësitë e Humbura, Mësime për të Ardhmen]. Në Haleh Ashfar & Deborah Eade (red.) *Development, Women and War: Feminist Perspectives* [Zhvillimi, Gratë dhe Lufta: Perspektiva Feministe]. *Oxfam Publishing*, 87– 99.

26
Shihni për më shumë: Krasniqi, V. (2011). *Feminism and nationalism [Feminizmi dhe nacionalizmi]. ProFemina (Summer/ Autumn)*, 53– 58; Di Lellio, A. & Schwandner-Sievers, S. (2006). The Legendary Commander: the construction of an Albanian master-narrative in post-war Kosovo [Komandanti Legjendar: ndërtimi i një master-narrative shqiptare në Kosovën e pasluftës]. *Nations and Nationalism. 12*(3): 513-529.

27
Pali, B., & Malaj, D. (2024). 'Against the state that kills women': using photo elicitation to explore grassroots feminist discourses on gendered violence in Albania and Kosovo ['Kundër shtetit që vret gratë': përdorimi i elicitimit fotografik për të eksploruar diskurset feministe në nivelin e bazës mbi dhunën gjinore në Shqipëri dhe Kosovë]. *Justice, Power and Resistance, 7*(1), 2-20.

28
Berisha, R. (2024). *The making of gender and the state in the newly independent Kosovo* [Bërja e gjinisë dhe shtetit në Kosovën e re të pavarur]. *Në: Feminist Encounters in Statebuilding. Understanding the role of women in making the state in Kosovo* [Hasjet Feministe në Shtetndërtim. Kuptimi i rolit të gruas në bërjen e shtetit në Kosovë]. Red: Musliu & Mujika Chao.

29
Luci, N. (2005). Transitions and Traditions: Redefining Kinship, Nation and Gender in Kosova [Tranzicionet dhe Traditat: Ripërcaktimi i Farefisnisë, Kombit dhe Gjinisë në Kosovë]. *Anthropological Journal on European Cultures*. Vol. 14.

Maliqi[30] dhe Krasniqi[31] veçmas kanë treguar se në dekadën e parë pas luftës, praktikat artistike që u shfaqën nuk u shkëputën nga çështja e identitetit kombëtar, përkatësisë dhe gjinisë. Shembuj të tillë janë artistet si Nurhan Qehaja, Fitore Isufi-Koja, Flaka Haliti, Qëndresa Deda, Merita Harxhi-Koci. Në dekadën e fundit, vendi ka parë gjithashtu një mobilizim feminist në rritje, i cili është më i ndërthurur krahasuar me lëvizjet e mëparshme. Ato mund të shihen si kundërvënie ndaj strukturës shtetërore patriarkale, si dhe evropianizimit neoliberal që i imponohet Kosovës.

Puna artistike e Nurhan Qehajës "Flamuri" (2005) dhe Fitore Isufi-Kojës "Japonia" (2006) janë shembuj thelbësorë të një rishqyrtimi dhe rezistence kundër shtetndërtimin (ndërkombëtar) në Kosovë. Ato të dyja prezantojnë materialitete dhe temporalitete feministe që janë në tension me agjendat e përcaktuara (neo)liberale të shtetndërtimit në vendin e ri. Duke vepruar kështu, ato dekonstruktojnë dhe çesencializojnë *gruan* dhe *shtetin* në sfondin e ristrukturimit të fuqishëm të ekonomisë politike të vendit duke shprishur narrativat neoliberale përmes arkivave, trupave dhe vështrimeve të grave.

Video e Nurhan Qehajës "Flamuri" është një ilustrim i gjallë i këtij tensioni, ku një femër nudo shfaqet në mes të natës duke kënduar himnin kombëtar shqiptar me flamurin e ankoruar mes këmbëve. Ky veprim ekspozon tensionin midis gruas si subjekt, e cila — bukfalisht — lind kombin, dhe materialitetin e saj, i cili është mezi i dukshëm në errësirë, që gjen pak artikulim. Ndërmjet viteve 1999 dhe 2008, Kosova u lëkund midis një territori të administruar nga OKB-ja në njërën anë dhe në pritje të zgjidhjes së statusit të saj përfundimtar si shtet i pavarur nga ana tjetër. Në vitin 2005, ndërsa negociatat ndërkombëtare për zgjidhjen e statusit të Kosovës ishin duke u zhvilluar, shqiptarët e Kosovës vazhduan të identifikohen me flamurin kombëtar shqiptar në sfondin e pasigurive dhe diskutimeve për prezantimin e një flamuri të ri pasi vendi të shpallte pavarësinë e tij. Përsëritja e himnit kombëtar dhe ndërprerja e tij e vazhdueshme — sikur i prerë në copa — në punën e Qehajës, na shërben si lexim i një simboli historik kombëtar që do të mënjanohej për të i hapur rrugë një himni të ri kombëtar dhe një flamuri të ri kombëtar që do të i atribuonte të ardhmes evropiane të Kosovës. Në vitin 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia, pas dy thirrjeve të mbikëqyrura ndërkombëtarisht për himnin kombëtar dhe flamurin kombëtar, autoritetet e Kosovës miratuan një himn të ri kombëtar — një melodi pa tekst të quajtur Evropë — dhe një flamur të ri kombëtar që ka një ngjashmëri të madhe në dizajn dhe ngjyra me flamurin e Bashkimit Evropian.

"Japonia" e Fitore Isufi-Kojës ofron gjithashtu një shqyrtim kritik të kësaj të ardhmeje evropiane të Kosovës dhe në të njëjtën kohë ekspozon tendencat patriarkale të kësaj natyre, megjithëse të paketuara si progresive, moderne dhe disi-evropiane. Përkundër pranisë së madhe të organizatave ndërkombëtare dhe evropiane që synojnë të i japin kah gjinisë në politikë dhe jetës publike në Kosovë, "Japonia" e Isufit shqyrton limitet e evropianizimit. Në videon e saj, himeni i gruas si burimi i vetëm i pastërtisë së saj, i dëshmuar me shenja gjaku në një çarçaf të bardhë, përfaqëson virtytin që bën *shtetin*. Narrativa e evropianizimit — e kuptuar si në thelb e mirë dhe progresive — pavarësisht, Isufi na tërheq vëmendjen se si pastërtia dhe vlera e *gruas kosovare* për shtetin mbetet e lidhur me strukturat arkaike dhe patriarkale. Në fillim të viteve 2000, Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) aplikoi një kuotë gjinore prej 30 për qind në listat e partive politike si një shënjues i rrugës evropiane. E implementuar vetëm disa vjet më vonë, "Japonia" tërheq vëmendjen tonë ndaj sistemeve strukturore patriarkale shtypëse që do të mbeten të paprekura deri më sot. Në këto sisteme, trupi i gruas, vështrimi i gruas dhe gruaja qeverisen dhe kontrollohen për të legjitimuar shtetndërtimin neoliberal në Kosovë.

Së fundi, të dyja punët sfidojnë kuptimet dhe reifikimet tradicionale të shtetit-komb. Historia tradicionale mbetet kokëfortësisht e përkushtuar ndaj dokumentimit, arkivimit dhe riprodhimit të historisë të formimit të shtetit-komb dhe shtetndërtimit përmes tytës së armës ose majës së një bajonete të mbajtur nga një figurë e fuqishme mashkullore. Ky riprodhim, veçanërisht nga shekulli i XIX-të e më tej, ka krijuar një tension midis *shtetit* dhe *subjekteve jo-meshkuj* të atij shteti, ndërkohë që kërkon punën, agjencinë dhe sakrificën e këtyre të fundit.

30
Maliqi, Sh. (2021). "Arti në rezistencë". Shtëpia Botuese Koliqi.

31
Krasniqi, E. (2022). 'Interrogating Exclusion: A Summary.' [Shqyrtimi i Përjashtimit: Një Përmbledhje] botuar në Secondary Archive, një platformë online e artisteve gra nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Edicioni i arkivit me artistet nga Kosova është kuruar nga Renea Begolli dhe Erëmirë Krasniqi. Linku: https://secondaryarchive.org/interrogating-exclusion-a-summary/

Disrupting Patriarchy in Neoliberal Statebuilding in Kosovo

Vjosa Musliu

This article reads two artistic works, Nurhan Qehaja's *The Flag* (2005) and Fitore Isufi-Koja *Japan* (2006), against the backdrop of fundamental political, economic and societal restructuring in post-war Kosovo. I argue that both works — separately and together — interrogate neoliberal statebuilding in Kosovo after the war in 1999 by displaying the inherent patriarchal structures that have remained intact in this process. Before discussing the works in and of themselves I first offer a brief illustration to the neoliberal restructuring of Kosovo since 1999. I focus on how this process was largely (self)deployed on a supposedly 'clean slate' that often disregarded local heritage in statebuilding and sidelined, if not outright ignored, prior feminist legacies. Finally, I reflect how these two works by Qehaja and Isufi intervene and deconstruct the patriarchy embedded in statebuilding processes that are legitimized through Europeanization.

After a brutal war conducted by Serbia's military against Kosovo Albanians in the late 1990s, Kosovo was subjected the entire spectrum of liberal interventionism including: NATO's airstrikes against Serbia and Montenegro that effectively ended the war (1999); the deployment of NATO ground troops in Kosovo (1999); a comprehensive United Nations administering mission (1999–2008); and the installment of a European Rule of Law Mission (2009–ongoing). In addition to the World Bank, International Monetary Fund and OSCE, these structures and institutions sought to create a state in Kosovo — a European Kosovo with neoliberal political and economic institutions — based on "highest international standards"[1] as if from scratch,[2] as if there had never existed anything there.

Scholars have analysed the tendency of liberal structures of interventionism to install a "year zero" in post-war societies, and their stubborn tendency to dictate the right way of developing,[3] the right way of civil society engagement,[4] the right way of performing gender (equality),[5] the right form of feminism, the right way of doing queer politics,[6] among others. At the same time, teaching "the locals" the right way of doing things in politics, arts, economics, civil action, has historically gone hand in hand with discrediting and/or disregarding previous systems, legacies and heritages.

The case of Kosovo, as I will show below, is a quintessential example of this logic. Due to its *unfinished* status as a fully-fledged independent state, Kosovo has been the perfect context and pretext to test the limits of (neo)liberal models. In a lot of ways, Kosovo experienced its very own unique *shock therapy* as it had to transform, almost overnight, from war to non-war, from an apartheid-like system of oppression to a democracy; and from a semi-controlled to an open market economy.

Much like across other former Yugoslav countries, per suggestion of the institutions of liberal interventionism, Kosovo underwent a severe form of privatization of its former socially owned social enterprises, and land expropriation, both of which were detrimental to its struggling economy.[7] Despite ample evidence of the disastrous impact of these policies on the ground, and despite ample historical evidence from experiences with privatization in countries in Eastern Europe and Latin America,[8] these neoliberal policies continued to be (self)legitimized and reified as not only the only alternative but also as civilizationally superior.

Micropolitics and everyday politics, such as family values, gender, sexuality, art, and knowledge production were also subsumed into the new ideological realm which in turn tries (if it has not done it already) to morph *the new Kosovar persona*, shorthand for *the neoliberal-European*

1
Musliu V. & Orbie J. (2014). "Deconstructing International Missions in Kosovo. What is in a name?". *European Foreign Affairs Review*. *19*(3): 411–428.

2
Musliu V. (2017). "Multi-ethnic democracy as an autoimmune practice: the case of international missions in Kosovo". *British Journal of Politics and International Relations*. *19*(1): 188–201.

3
Rutazibwa, O. (2014). 'Studying Agaciro. Moving beyond Wilsonian Interventionist Knowledge Production on Rwanda', *Journal of Intervention and Statebuilding, 8*(4), 291–302.

4
Musliu V. (2021). *Europeanisation and Statebuilding as Everyday Practices: Performing Europe in the Western Balkans*. Routledge Studies in Intervention and Statebuilding. London: Routledge.

5
Musliu, V. & Mujika Chao, I. (2024). *Feminist Encounters in Statebuilding. Understanding the role of women in making the state in Kosovo*. Routledge Studies in Intervention and Statebuilding. London: Routledge.

6
Rexhepi, P. (2017). The Politics of (Post) Socialist Sexuality: American Foreign Policy in Bosnia and Kosovo. In: Jelača, D., Kolanović, M., Lugarić, D. (eds) The Cultural Life of Capitalism in Yugoslavia. Palgrave Macmillan, Cham.

7
Mustafa, A. (2020). Kosovo's social policy during self-management, UNMIK and independence: Persisting high inequality and social exclusion. *International Journal of Social Welfare. 29*(1): 96–108.

8
Galeano, E. (1997). Open Veins of Latin America: Five Centuries of the Pillage of a Continent. Monthly Review Press.

Kosovar persona. *The new neoliberal-European Kosovar persona* is (self) detached from its Yugoslav socialist heritage as well as from the legacy of the parallel system of the 1990s. Instead, it is thought of as a *tabula rasa* — wherein ideals of democracy, open market economy, entrepreneurship and competitiveness are gradually enshrined and (self)internalized. Following Brown and Rottenberg, neoliberalism here is understood not merely as a set of economic policies but as a dominant political rationality that recasts individuals as human capital and by extension, capital-enhancing agents. And even though, as an economic order, neoliberalism relies on reproduction and care work, it also regulates that this care work and the generation of the so-called human capital naturally falls on the shoulders of women. Thus the new neoliberal-European-modern-woman in Kosovo is molded as the aspirational subject who strikes the *balance* between high ambition, competitiveness and entrepreneurial-like success on the one hand and familial care and reproduction on the other.

In this new reading, notions such as *European, liberal, neoliberal,* and *modern* are deliberately conflated, rendered as essentially the same and as a natural progression from one another at the same time. Erëmirë Krasniqi shows that under these new conditions, the contemporary art scene in Kosovo also became the agent to platform discussions on the depoliticization of society, human rights violations and the normalization of patriarchy, among other structures.[9]

> "Largely communicated to the public through the rhetoric of Europeanisation, [such] political aspiration encapsulated a neoliberal agenda of development, where national progress is tied to individual economic self-realisation. Cultural values and premises of neoliberalism such as the valorisation of free, rationalized and meritocratic agents abstracted from existing socio-economic structures were promoted as the new and desirable qualities. In this respect, the project of Kosovo as a European state in the making, prompted a reconfiguration of national identities that adhere to the agenda of the state-building project and Europeanisation."[10]

Paradoxically, as the Kosovo case would come to show, the international liberal state building has not been gender progressive[11] or sexually emancipatory.[12] For example, in 2005, women's rights and feminist activists hung a banner in the fence of Kosovo's government building in the city center of Prishtina, sending a clear message: *Resolution 1325 guarantees us participation in Negotiations [Rezoluta 1325 na garanton pjesëmarrjen në Negociata]*.[13] The UN-mediated negotiations between Prishtina and Belgrade between 2006 and 2008 that aimed at finding a settlement on Kosovo's final status barely included any women and did not acknowledge women's claims for gender equality. In doing so, they did not take into account the defence of women's rights and claims through the process, despite increasing international measures such as the United Nations Security Council (UNSC) Resolution 1325 (2000), which advocates for the equal participation of women in all decision-making spaces in conflict resolution and peacebuilding.

By extension, they also (deliberately) failed to acknowledge the activism and politics of women-led and feminist movements prior to 1999. Over the past 25 years of (international) statebuilding in Kosovo, practices of (neo)liberal restructuring have been continuously met with acts of resistance from feminist and women-led movements in relation to the politics of gender restructuring, and the environmental and societal impact of privatization, among other issues.

9
Krasniqi, E. (2022). "Interrogating Exclusion: A Summary." published on Secondary Archive, a platform for women artists from Central and Eastern Europe. The Kosovo edition of the archive was curated by Renea Begolli and Erëmirë Krasniqi. Link: https://secondaryarchive.org/interrogating-exclusion-a-summary/

10
Berisha, R. (2024). The making of gender and the state in the newly independent Kosovo. In: *Feminist Encounters in Statebuilding. Understanding the role of women in making the state in Kosovo*. Ed: Musliu & Mujika Chao.

11
Musliu, V. (2021). *Europeanisation and Statebuilding as Everyday Practices: Performing Europe in the Western Balkans*. Routledge Studies in Intervention and Statebuilding. London: Routledge.

12
Rexhepi, P. (2022). *White Enclosures Racial Capitalism and Coloniality along the Balkan Route.* Duke University Press.

13
Kosova Women's Network. (2005). Kosova Women's Network annual report 2005. Prishtina: Kosovo Women's Network. https://womensnetwork.org/publications/ kwn-annual- report-2005/

The paradox of a *tabula rasa*

Kosovo was the most underdeveloped region in the former Yugoslavia. By the end of the Second World War, more than 80 percent of Kosovo's population was illiterate, and this percentage was even higher amongst women and girls. This overview appears even grimmer in the arts and culture. The first gallery in Kosovo was opened only in 1979 (the University of Pristina was opened four years prior to that) with many artists of that time representing the stylistic influences of the art scenes in Yugoslavia[14] even though they also strove to create a new, differentiated aesthetics of their own.[15]

The decade of the 1990s is largely characterized by the so-called parallel system in Kosovo. 150 thousand people were expelled from public jobs and around 400 thousand students and pupils were taken out of public schools. Ousted from all public institutions — medical, educational, cultural and economic — Albanians, who comprised over 80 percent of the population in Kosovo at that time, self-organized in parallel structures maintaining the bureaucratic, legal, social and economic layers of a state within a state. The repressive measures were even more grave for the artistic scene with art galleries, theatres and cultural activities shifting to dingy cafes and in the peripheries of Kosovo towns.

EK On the other hand, although the ideas were not thoroughly examined, there are many high-quality videos from this period. Personally, I don't have a critical stance, because to me they are artifacts of that time and they seem to me very unique and symptomatic of that moment. However, in the meantime, the culture of how we consume visual content has changed, we are much more exposed to video content, and a visual overload occurs. Since 2010, the artists of this generation no longer produce videos.

FI-K In fact, it's not that they don't create anymore, but they no longer have that enthusiasm. It was a kind of collective moment to engage with this media. And we were perhaps provoked because it was easier to distribute to curators on CDs. On the other hand, the video art that Mehmet Behluli presented to us during the lectures, which were held at Exit, was easier to show and make accessible, because as students, we didn't have the opportunity to visit galleries or museums abroad. Through videos, you easily had access to the works of international artists. This perhaps injected in us the desire to try articulating through video, because all the accessible art at that time was in video format.

EK In what other contexts has this work been presented?

FI-K *Japan* was presented at the National Gallery of Kosovo as part of the Artists of Tomorrow Award in 2006. I was the winner of this award that year. Later, Eriola Pira gathered all the winners from Southeast Europe and exhibited them at the National Gallery of Kosovo a year later. Then it was exhibited at MIZA Gallery in Tirana, in my solo exhibition, in 2015. Then, in 2016 it was also exhibited in the exhibition *The Whale That Was a Submarine* at the Ludwig Museum. An exhibition that gathered artists from Kosovo and Albania to reflect on the developments of contemporary art in these two countries with the same language and culture, but different ideological paths. However, this work has not been widely exhibited. It has perhaps been more often discussed when talking about this period, but not frequently displayed in exhibition spaces. Today, it is part of the Ludwig Museum's collection in Budapest, where it was also exhibited as part of the selection from the collection Westkunst-Ostkunst from 2017-2020, an exhibition that aimed to present a parallel between Western and Eastern art, highlighting the characteristics, commonalities, and differences within the contexts of these geographies.

This interview was conducted on November 21st, 2023. It has been lightly edited and condensed for clarity.

Zanafilla dhe Amplifikimi i Përfytyrimit Politik Kombëtar në Turqi

Onur Yıldız

Vitet 1990 në Turqi shënuan një epokë domethënëse të karakterizuar nga konflikte dhe trazira politike. Kjo periudhë ishte dëshmitare e ndikimit të përhapur të konflikteve dhe dhunës, të nënvizuara nga konfrontimet midis forcave të sigurisë dhe Partisë Punëtore të Kurdistanit (PKK), krahas dominimit në rritje të retorikës politike nacionaliste brenda diskursit publik turk, të katalizuar nga këto konflikte të tejzgjatura. PKK, e cila vepron në Irak, Iran dhe Siri, me popullsi kryesisht kurde në rajone të caktuara, i ka përqendruar aktivitetet e saj në lindje dhe juglindje të Turqisë. Pasojat e aktiviteteve të tyre, megjithatë, kumbuan në të gjithë vendin. Përhapja e diskursit nacionalist shkaktoi një ndryshim të dukshëm, duke e ngritur diskursin e subjekteve politike nacionaliste në një pozicion hegjemonist, jo vetëm brenda diskursit politik zyrtar, por edhe brenda shoqërisë civile. Njëkohësisht, gramatika dhe fjalori i diskursit politik mbizotërues u bashkuan rreth parimeve nacionaliste, ndërsa repertori vizual dhe simbolik që shoqëronte këtë rrëfim nacionalist përshkoi fushat zyrtare dhe atë civile, duke ngulitur kështu përfytyrimin nacionalist brenda shtofit shoqëror.

Nga njëra anë, qëndrimi politik ndaj diskursit nacionalist që bëhet i vetmi përfytyrim politik 'i mundshëm' dhe 'legjitim' është fuqizuar duke përdorur sjellje penguese, ndëshkuese dhe në disa raste edhe shpërblyese servile, ndërsa nga ana tjetër, përfytyrimi civil nacionalist i formësuar nga ndikimi i diskursit zyrtar ka kontribuar në përhapjen e fjalorit dhe repertorit vizual nacionalist[1]. Krahas ceremonive zyrtare të organizuara nga shteti, tubimet civile që nga ndeshjet e futbollit e deri te funeralet e dëshmorëve u shndërruan në një tregues force që i mundësoi përfytyrimit civil nacionalist të riprodhohej dhe të përhapej[2]. Përdorimi i simboleve nacionaliste dhe shtetërore u përhap dhe dukshmëria e tyre, në mënyrë të pashmangshme, u rrit. Përveç dukshmërisë së shtuar dhe të përhapur të flamurit turk nga institucionet shtetërore, flamuri u shndërrua në një simbol që përdorej në bizhuteri, aksesorë dhe veshje. Ndeshjet e futbollit, koncertet, madje edhe sfilatat e modës, u bënë pjesë e organizimeve zyrtare — që më parë ishin të kufizuara në këtë drejtim — dhe këndonin himnit kombëtar[3].

Zanafilla dhe evolucioni i imagjinatës dhe repertorit nacionalist në Turqi mund të gjurmohen prapa në kohë në një periudhë para viteve 1990. Dalja në shesh e lëvizjeve nacionaliste separatiste gjatë viteve të rënies së Perandorisë Osmane, që përfshinte entitete si nacionalizmat grek, serb, bullgar, shqiptar dhe arab, shënoi rënien e idealit të bashkëjetesës ndëretnike brenda perandorisë. I ngulitur brenda shtofit multikulturor dhe multietnik të perandorisë, në mënyrë të pashmangshme, nacionalizmi u shfaq përmes konfliktit, luftës dhe dhunës. Nacionalizmi turk — i shfaqur pjesërisht si një përgjigje ndaj lëvizjeve nacionaliste separatiste dhe pjesërisht i ndikuar nga kontakti me botën Perëndimore dhe iniciativat e modernizimit — ka qenë një komponent kryesor i këtij përshkallëzimi historik të konfliktit, luftës dhe dhunës që nga shekulli i XVIII-të. Duke funksionuar si paraardhës dhe përfitues i qeverisjes shtetërore brenda Perandorisë Osmane, një sferë ku individë me prejardhje të ndryshme fetare dhe etnike bisedonin në një mori gjuhësh, nacionalizmi turk nxiti një diskurs të sofistikuar dhe leksik vizual për të lehtësuar ndërtimin e një shteti-komb që është homogjen për nga etnia, feja dhe gjuha.

Veçanërisht gjatë viteve 1920 dhe 1930, mund të pretendohet se korniza diskursive dhe vizuale e nacionalizmit turk pësoi një mobilizim të rëndësishëm. Përpjekja për të ndërtuar një komb turk të karakterizuar nga homogjeniteti etnik, fetar dhe gjuhësor, në përputhje me parimet e shtetit-komb, përbënte një përpjekje të përbashkët ku aparati institucional zyrtar, krahas aspekteve të ndryshme të ekzistencës shoqërore, duke përfshirë mënyrat e perceptimit dhe ndjenjat në nivel individual, ishin të ngulitura brenda një paradigme nacionaliste. Kjo paradigmë nacionaliste, duke evoluar përmes një mobilizimi ku shteti përdori aparatet dhe autoritetin e tij zyrtar, gjysmë zyrtar dhe civil për të shpërblyer dhe sanksionuar, jo vetëm formësoi trajta të reja të subjektivitetit, por gjithashtu përvijoi hierarkinë simbolike brenda së cilës vepronin këto subjekte[4].

1
Ünlü, B. (2018). *Türklük Sözleşmesi: Oluşumu, İşleyişi ve Krizi* [Kontrata e Turqizmit: Formimi, Operacioni dhe Kriza e saj]. Shtëpia botuese Dipnot.

2
Bora, T. (1995). *Milliyetçiliğin Kara Baharı* [Pranvera e Errët e Nacionalizmit]. Shtëpia botuese İletişim.

3
Po aty. f. 76.

4
Ünlü, B. (2018). *Türklük Sözleşmesi: Oluşumu, İşleyişi ve Krizi* [Kontrata e Turqizmit: Formimi, Operacioni dhe Kriza e saj]. Shtëpia botuese Dipnot.

Ndikimi i shtetit mbi arsimin, kulturën dhe dinamikat shoqërore u përqëndruan në përhapjen e paradigmës nacionaliste dhe kultivimin e mënyrave të veçanta të perceptimit dhe njohjes, veçanërisht në mesin e popullatës së re, përmes prizmit të nacionalizmit[5]. Për më tepër, ky proces i formësimit të një individi të ri, modern dhe nacionalist u fuqizua më tej përmes thjerrëzave të anti-komunizmit përgjatë epokës së Luftës së Ftohtë.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Turqia u rreshtua me koalicionin Perëndimor, e nxitur nga kërcënimi që supozohej se Bashkimi Sovjetik përfaqësonte dhe sentimenti tashmë ekzistues anti-komunist. Institucionet shtetërore, të mobilizuara gjerësisht kundër spektrit të komunizmit, u përpoqën me zell të ndrydhin çdo diskurs politik që thirrej në ideologji komuniste nëpërmjet ndalimit të partive politike, paraburgimeve të shumta, censurës dhe vendosjes së masave të ndryshme represive. Njëkohësisht, mes kërkesave të epokës, diskursi politik nacionalist u rivlerësua si një mjet praktik.

Ky rivlerësim ishte i dyfishtë: së pari, si bazë për frontin anti-nazist, ai synonte të parandalonte përhapjen e narrativave raciste që kujtonin nazizmin; së dyti, u përpoq të mirëmbante praktika që shtypnin dhe penalizonin pakicat muslimane dhe jomuslimane[6]. Nëpërmjet mekanizmave të tillë si Taksa mbi Pasurinë[7], doktrina politike nacionaliste u pozicionua si forca mbizotëruese që diktonte sferat ekonomike dhe shoqërore.

Vitet 1960 dhe 1970 ishin dëshmitare të daljes në publik të lëvizjeve politike majtiste dhe opozitare në Turqi, kështu duke pasqyruar tendencat globale. Krahas thirrjeve të zjarrta për barazi dhe drejtësi sociale, narrativat politike majtiste-socialiste, që përfshinin avokimin për liri dhe të drejtat e kulturave dhe identiteteve të ndryshme, u përplasën me ideologjitë mbizotëruese anti-komuniste dhe nacionaliste. Leksiku i diskursit zyrtar nacionalist, së bashku me paradigmën nacionaliste që asocohej me të, përjetoi rritje në mes të ngritjes së disidencës politike majtiste-socialiste. Konservatorizmi fetar dhe nacionalizmi gjetën gjuhën e përbashkët në anti-komunizëm, duke krijuar një front të unifikuar si në aspektin retorik ashtu edhe në atë intelektual.

Grusht shteti ushtarak i 12 shtatorit të vitit 1980 dhe diktatura ushtarake pasuese paralajmëruan një periudhë gjatë së cilës aleanca midis nacionalizmit dhe konservatorizmit fetar u zyrtarizuan dhe iu dha njohja zyrtare. Ky konstrukt ideologjik, i njohur si sinteza turko-islamike[8], mori miratimin nga junta ushtarake që orkestroi grusht shtetin dhe u perceptua si i vetmi diskurs legjitim politik, i cili pa u vënë në pyetje mbizotëronte si në nivelet zyrtare ashtu edhe në ato shoqërore, për shkak të qëndrimit autokratik të regjimit të post-grusht shtetit. Ndryshime të shumta u bënë në kurrikulat arsimore, duke detyruar mësimin fetar, ndërsa financimi shtetëror fuqizoi botimet fetare. Njëkohësisht, ndërsa lëvizjet e fuqishme socialiste të viteve 1970 u shtypën dhe u penalizuan përmes ndërhyrjes ushtarake, nacionalizmi mori primatin e moralit bazë për të organizuar mjedisin socio-politik, i dekretuar nga shteti dhe i rrënjosur brenda strukturës shoqërore të formësuar nga ndikimi shtetëror.

Sundimi ushtarak në Turqi mori fund me zgjedhjet e mbajtura në vitin 1983. Administrata civile që mori pushtetin pas zgjedhjeve nuk u angazhua në një konfrontim domethënës me

5
Ahıska, M. (2005). *Radyonun Sihirli Kapısı: Garbiyatçılık ve Politik Öznellik* [Dera Magjike e Radios: Oksidentalizmi dhe Agjencia Politike]. Shtëpia botuese Metis.

6
Turqia iu bashkua koalicionit anti-nazist vetëm në fund të Luftës së Dytë Botërore. Kjo përfshirje e vonuar zakonisht i atribuohet shqetësimeve rreth sigurisë që kishte pasur elita politike dhe hezitimit të tyre për të u përfshirë në konflikt të drejtpërdrejtë me Gjermaninë naziste. Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme të pranohet se një segment i elitës politike turke ushqente simpati për ideologjinë naziste. Për një pasqyrë më të detajshme rreth qëndrimit të Turqisë gjatë Luftës së Dytë Botërore shih; VanderLippe, J. M. (2001). A Cautious Balance: The Question of Turkey in World War II [Një bilanc i kujdesshëm: Çështja e Turqisë në Luftën e Dytë Botërore]. *The Historian*, 64(1), 63–80.

7
Për një përshkrim të Tatimit mbi Kapitalin në Turqi shihni: Edward C. Clark (1972). *The Turkish Varlık Vergisi Reconsidered* [Varlık Vergisi Turk i Rishqyrtuar]. *Middle Eastern Studies*, 8:2, 205-216.

8
Shihni: Ö. ALKAN, M. (2014). Militarist Turkish-Islamic Synthesis: Official Ideology, Official History and Nationalism in the Second Constitutional Period [Sinteza Militariste Turko-Sslamike: Ideologjia Zyrtare, Historia Zyrtare dhe Nacionalizmi në Periudhën e Dytë Kushtetuese]. *Türkiye Ortadoğu Çalışmaları Dergisi*, 1(2), 147-172.

ideologjinë zyrtare të etabluar nga grusht shteti. Praktikat autoritare të shtetit, krahas me neoliberalizimin e ekonomisë, ndrydhën disidencën me bazë në drejtësi sociale dhe kërkesat për më shumë të drejta. Lëvizjet e punës, sindikatat dhe fraksionet politike majtiste-socialiste u përballën me shtypje të rreptë. Konturat e arenës politike u përcaktuan nga ideologjia zyrtare nacionaliste, duke krijuar një kornizë vizuale, dëgjimore dhe intelektuale të lejuar brenda këtyre kufijve, duke u shtrirë në të dy fushat, atë politike dhe shoqërore. Nacionalizmi u rrënjos brenda procesit të gjerë të neoliberalizimit të kësaj epoke, duke mishëruar një qëndrim politik antagonist ndaj disidencës të orientuar drejt lirisë dhe të drejtave që u shpërshfaqën në mes të këtij transformimi.

Konflikti i armatosur midis forcave të sigurisë dhe PKK-së, që filloi në mesin e viteve 1980 dhe vazhdoi gjatë gjithë viteve 1990, ka formësuar thellësisht peizazhin politik të vendit. Përshkallëzimi i vetëdijes rreth sigurisë nga ana e shtetit pengoi tutje kornizën demokratike tashmë të lëkundur, të krijuar pas grusht shtetit ushtarak. I gjithë mjedisi politik, duke përfshirë të drejtat dhe liritë themelore, u orientua drejt imperativave të sigurisë të pohuara nga shteti. Autoritarizmi që pasoi u përpoq të shtyp çdo përgjigje politike përtej nacionalizmit si përgjigje ndaj konflikteve. Strukturat kuazi-zyrtare të ngjashme me Gladio[9], të konceptuara si kundërmasa ndaj kërcënimit komunist gjatë Luftës së Ftohtë, morën një rol të ri në mes të kësaj periudhe të karakterizuar nga trazirat. Aktet e supozuara të dhunës të kryera nga këto subjekte, që operonin përtej kompetencës së aparatit zyrtar të sigurisë së shtetit, u shqyrtuan në mënyrë joadekuate përmes kanaleve ligjore. Natyra siguri-centrike e paradigmës nacionaliste këmbënguli si moral politik mbizotërues, përbrenda qarqeve zyrtare ashtu edhe në sferën civile gjatë kësaj epoke.

Gjatë gjithë këtyre zhvillimeve historike, nacionalizmi ka funksionuar si një kornizë e rëndësishme politike, duke shërbyer për të përcaktuar kufijtë. Ai ka funksionuar si një racionale që bën dallimin midis përfshirjes së “neve” dhe përjashtimit të “të tjerëve”. Kjo dikotomi, midis atyre që përqafohen brenda kombit dhe atyre të shtyer jashtë kufijve të tij, formëson procesin themelor të ndërtimit të identitetit brenda arenës politike. Si një konstrukt shoqëror, nacionalizmi ka instituuar një regjim të normave shoqërore, si një shtrirje e racionales së tij themeltare politike. Ka diktuar veprime dhe diskursin e lejueshëm, duke përcaktuar kufijtë e së pranueshmës. Ndërsa zbatimi i nacionalizmit nga ana e shtetit është manifestuar përmes praktikave të ndryshme në fusha ligjore, ndëshkuese, ideologjike dhe kulturore, nacionalizmi brenda shoqërisë civile gjithashtu krijoi ritualet përditshme të veta të zbatueshme.

Zbatimi i përditshëm i nacionalizmit mund të konceptohet si një referendum i përsëritur, ku nacionalizmi riafirmohet në baza ditore[10]. Çdo qytetar është i detyruar të u përmbahet parimeve të ideologjisë nacionaliste dhe të mirëmbajë në mënyrë rutinore përfytyrimin nacionalist. Çdo pengesë ose kundërshtim i hasur gjatë këtij zbatimi të përditshëm të nacionalizmit mund të çojë potencialisht në një zhvendosje përtej kufirit të përcaktuar midis aleatit dhe kundërshtarit brenda sferës politike. Pavarësisht përpjekjeve të narrativës nacionaliste për të parandaluar mospajtimin duke ofruar koncesione në formën e shpërblimeve dhe ndëshkimeve, kjo qasje rezultoi e pasuksesshme. Aktorë të shumtë politikë dhe shoqërorë vënë në pah shtypjen, dhunën dhe pabarazinë e shkaktuar nga ideologjia dhe praktikat nacionaliste dhe ofruan perspektiva alternative për të perceptuar sferën politike dhe rrugë të ndryshme për subjektivitetin politik. Këto kahje të dyfishta të disidencës u shfaqën si modalitete kryesore të kontestimit kundër konstruktit nacionalist.

Kjo kritikë ndonjëherë manifestohej në formimin e subjektiviteteve dhe aleancave të reja politike të rrënjosura në korniza politike alternative. Për shembull, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1991, koalicioni midis Partisë Populiste Social Demokrate dhe Partisë Popullore të Punës propozoi një paradigmë

9
Gladio u formua si një rrjet i fshehtë i rezistencës përbrenda vendeve të NATO-s për të parandaluar aktivitetin socialist/komunist. Shih: Ferraresi, F., & Castagna, J. (1992). A Secret Structure Codenamed Gladio [Struktura e Fshehtë me Emrin e Koduar Gladio]. *Italian Politics*, 7, 29-48.

10
Bora, T. (1995). *Milliyetçiliğin Kara Baharı* [Pranvera e Errët e Nacionalizmit]. Shtëpia botuese İletişim.

politike alternative duke bashkuar një parti socialdemokrate me lëvizjen politike kurde, megjithëse pa sukses. Në tandem me zhvillimin e diskurseve dhe kornizave alternative politike, opozitarizmi ndaj paradigmës nacionaliste është manifestuar në një shkallë më të gjerë përmes përpjekjeve për të drejta dhe njohje në vitet 1990. Organizata të tilla si Shoqata për të Drejtat e Njeriut (IHD) kanë luajtur një rol të rëndësishëm në vënien në pah të shkeljeve të të drejtave të cenuara nga diskurset dhe praktikat e sigurizuara dhe nacionaliste. Ato gjithashtu kanë qenë në krye të përpjekjeve të nevojshme politike dhe ligjore për të identifikuar dhe korrigjuar këto shkelje të të drejtave.

Historia e vonë e Turqisë karakterizohet nga përpjekjet e vazhdueshme të diskurseve nacionaliste për të kornizuar konfliktet politike bashkëkohore, përfshirë këtu migrimin, varfërinë dhe autoritarizmin, përbrenda kufijve tematikë të fjalorit nacionalist, si siguria, mbijetesa dhe uniteti. Është e qartë se autoritarizmi gjithnjë në rritje në Turqi frymëzohet nga repertori historik i imagjinatës politike nacionaliste. Kjo vazhdimësi e ashpër midis nacionalizmit të përhapur në vitet 1990 dhe diskursit dhe praktikave aktuale të politikës nacionaliste në Turqi, shërben si një përkujtues i gjallë i imperativit për të njohur dhe theksuar padrejtësitë e kryera. Ajo nënvizon domosdoshmërinë për të anticipuar dhe kultivuar mënyra egalitare dhe emancipuese të të kuptuarit, interpretimit dhe riformësimit të peizazhit politik.

Genesis and Amplification of the National Political Imaginary in Turkey

Onur Yıldız

The 1990s in Turkey marked a significant epoch characterized by political strife and turmoil. This period witnessed the pervasive influence of conflicts and violence, underscored by the confrontations between security forces and the Kurdistan Workers' Party (PKK), alongside the burgeoning ascendancy of nationalist political rhetoric within Turkish public discourse, catalyzed by these protracted conflicts. The PKK, which operates in Iraq, Iran and Syria, which have predominantly Kurdish populations in certain regions, has, in Turkey, concentrated its activities in the east and southeast. The repercussions of its activities, however, have reverberated throughout the country. The proliferation of nationalist discourse engendered a perceptible shift, elevating the nationalist politics entities to a hegemonic position, not solely within official political discourse but also within civil society. Concurrently, the grammar and vocabulary of prevailing political discourse coalesced around nationalist tenets, while the visual and symbolic repertoire accompanying this nationalist narrative permeated both official and civilian domains, thus enshrining the nationalist imaginary within the societal fabric.

On the one hand, the political attitude towards the nationalist discourse becoming the only 'possible' and 'legitimate' political imaginary has fortified itself by using prohibitive, punitive, and in some cases even rewarding obedient behavior, while on the other hand, the civil nationalist imaginary shaped by the influence of the official discourse has contributed to the spread of the nationalist vocabulary and visual repertoire.[1] In addition to the official ceremonies organized by the state, civil gatherings ranging from football matches to martyrs' funerals turned into a show of force that enabled the civil nationalist imaginary to reproduce and spread itself.[2] The use of nationalist and state symbols became widespread and their visibility, inevitably, increased. In addition to the intensive and widespread display of the Turkish flag by state institutions, the flag became a symbol used on jewelry, accessories, and clothing. Football matches, concerts, and even fashion shows, were added to the official — and previously limited — occasions for singing the National Anthem.[3]

The genesis and evolution of the nationalist imagination and repertoire in Turkey can be traced back to a period predating the 1990s. The emergence of separatist nationalist movements during the twilight years of the Ottoman Empire, encompassing entities such as Greek, Serbian, Bulgarian, Albanian, and Arab nationalisms, marked the demise of the ideal of interethnic coexistence within the empire. Embedded within the multicultural and multiethnic fabric of the empire, nationalism inevitably manifested through conflict, warfare, and violence. Turkish nationalism — emerging partly as a response to separatist nationalist movements and partly influenced by encounters with the Western world and modernisation initiatives — has been a pivotal component of this historical spiral of conflict, warfare, and violence since the 18th century. Functioning as both the progenitor and beneficiary of state governance within the Ottoman Empire, a realm where individuals from diverse religious and ethnic backgrounds conversed in myriad languages, Turkish nationalism fostered a sophisticated discourse and visual lexicon to facilitate the construction of an ethnically, religiously, and linguistically homogeneous nation-state.

Particularly during the 1920s and 1930s, one can claim that the discursive and visual framework of Turkish nationalism underwent significant mobilization. The endeavor to construct a Turkish nation characterized by ethnic, religious, and linguistic homogeneity, in line with the tenets of the nation-state, constituted a concerted effort wherein the official institutional apparatus, alongside various facets of societal existence, including modes of perception and sentiment at the individual level, were entrenched within a nationalist paradigm. This nationalist paradigm, evolving through a mobilization wherein the state utilized its official,

1
Ünlü, B. (2018). *Türklük Sözleşmesi: Oluşumu, İşleyişi ve Krizi* [The Contract of Turkishness: Formation, Operation and It's Crisis]. Dipnot Publishing.

2
Bora, T. (1995). *Milliyetçiliğin Kara Baharı* [The Dark Spring of Nationalism]. İletişim Publishing.

3
Ibid. p.76.

semi-official, and civilian apparatuses and authority to dispense both rewards and sanctions, not only molded novel forms of subjectivity but also delineated the symbolic hierarchy within which these subjects operated.[4] The state's influence over education, culture, and social dynamics centered on the propagation of the nationalist paradigm and the cultivation of particular modes of perception and cognition, particularly among the younger populace, through the prism of nationalism.[5] Furthermore, this process of fashioning a novel, modern, and nationalist individual was further bolstered through the lens of anti-communism during the advent of the Cold War era.

Following the end of the Second World War, Turkey aligned itself with the Western coalition, driven by the perceived threat posed by the Soviet Union and preexisting anti-communist sentiments. State institutions, mobilized extensively against the specter of communism, diligently endeavored to stifle any political discourse invoking communist ideology through the banning of political parties, widespread detentions, censorship, and the deployment of various repressive measures. Concurrently, amidst the exigencies of the era, nationalist political discourse was re-evaluated as a viable recourse.

This reassessment was twofold: firstly, as a constituent of the anti-Nazi front, it aimed at forestalling the propagation of racist narratives reminiscent of Nazism; secondly, it sought to perpetuate practices that oppressed and penalized both Muslim and non-Muslim minorities.[6] Through mechanisms such as the Wealth Tax [*Varlık Vergisi*],[7] nationalist political doctrine persisted as the predominant force dictating the economic and social spheres.

The 1960s and 1970s witnessed the emergence of leftist and oppositional political movements in Turkey, mirroring global trends. Alongside fervent calls for social equity and justice, leftist-socialist political narratives, incorporating advocacy for freedom and the rights of diverse cultures and identities, clashed with prevailing anti-communist and nationalist ideologies. The lexicon of the official nationalist discourse, along with its associated nationalist paradigm, underwent augmentation amidst the ascent of leftist-socialist political dissent. Religious conservatism and nationalism found common ground in anti-communism, forging a cohesive front both rhetorically and intellectually.

The military coup d'état of September 12th, 1980 and the subsequent military dictatorship heralded a period during which the alliance between nationalism and religious conservatism was formalized and accorded official recognition. This ideological construct, known as the Turkish-Islamic Synthesis,[8] garnered endorsement from the military junta that orchestrated the coup and was perceived as the sole legitimate political discourse, prevailing unchallenged at both official and societal echelons, owing to the autocratic disposition of the post-coup regime. Alterations were made in educational curricula, mandating religious instruction, while state funding bolstered religious publications. Concurrently, as robust socialist movements of the 1970s were quashed and penalized by military interventions, nationalism assumed primacy as the foundational ethos for organizing the socio-political milieu, both promulgated by the state and ingrained within the societal fabric molded by state influence.

4
Ünlü, B. (2018). *Türklük Sözleşmesi: Oluşumu, İşleyişi ve Krizi* [The Contract of Turkishness: Formation, Operation and It's Crisis]. Dipnot Publishing.

5
Ahıska, M. (2005). *Radyonun Sihirli Kapısı: Garbiyatçılık ve Politik Öznellik* [The Magic Door of the Radio: Occidentalism and Political Agency]. Metis Publishing.

6
Turkey joined the Anti-Nazi coalition only towards the end of World War II. This delayed involvement is typically attributed to the security concerns of the political elite and their reluctance to engage in direct conflict with Nazi Germany. However, it is also important to recognize that a segment of the Turkish political elite harbored sympathies for Nazi ideology. For an account of Turkey's stance during the Second World War see; VanderLippe, J. M. (2001). A Cautious Balance: The Question of Turkey in World War II. *The Historian*, 64(1), 63–80.

7
For an account of the Capital Tax in Turkey see: Edward C. Clark (1972). The Turkish Varlık Vergisi Reconsidered. *Middle Eastern Studies*, 8:2, 205-216.

8
See: Ö. ALKAN, M. (2014). Militarist Turkish-Islamic Synthesis: Official Ideology, Official History and Nationalism in the Second Constitutional Period. *Türkiye Ortadoğu Çalışmaları Dergisi*, 1(2), 147-172.

Military rule in Turkey came to an end with the elections held in 1983. The civilian administration that assumed power following the elections did not engage in significant confrontation with the official ideology established by the coup. The authoritarian practices of the state, concurrent with the neoliberalization of the economy, stifled dissent grounded in social justice and rights-based demands. Labour movements, trade unions, and leftist-socialist political factions faced stringent repression. The contours of the political arena were delineated by the official nationalist ideology, giving rise to a visual, auditory, and intellectual framework permissible within these confines, extending across both political and social domains. Nationalism became entrenched within the extensive neoliberalisation process of this era, embodying a political stance antagonistic to rights and freedom-oriented dissent emerging amidst this transformation.

The armed conflict between the security forces and the PKK, commencing in the mid-1980s and persisting throughout the 1990s, has profoundly shaped the political landscape of the country. The escalating security apprehensions of the state further impeded the already faltering democratic framework, established in the aftermath of the military coup. The entire political milieu, inclusive of foundational rights and liberties, became oriented towards security imperatives asserted by the state. Concomitant authoritarianism sought to quash any political response beyond nationalism in response to the conflicts. The quasi-official structures akin to Gladio,[9] which was conceived as a countermeasure to the communist threat during the Cold War, assumed a renewed role amid this period of turmoil. Alleged acts of violence perpetrated by these entities, operating beyond the purview of the state's official security apparatus, remained inadequately scrutinized through legal channels. The security-centric nature of the nationalist paradigm persisted as the predominant political ethos, within both official circles and the civilian domain, throughout this epoch.

Throughout these historical developments, nationalism has functioned as a pivotal political framework, serving to delineate boundaries. It has operated as a rationale that distinguishes between the inclusion of "us" and the exclusion of "others". This dichotomy, between those embraced within the nation and those relegated beyond its confines, forms the fundamental process of identity construction within the political arena. As a social construct, nationalism has instituted a regimen of social norms as an extension of its founding political rationale. It has dictated permissible actions and discourse, delineating boundaries of acceptability. While the state's enactment of nationalism was manifested through various practices across legal, punitive, ideological, and cultural domains, nationalism within civil society also engendered its own daily rituals.

The daily enactment of nationalism can be conceptualized as a recurring plebiscite, wherein nationalism is reaffirmed on a daily basis.[10] Each citizen is compelled to adhere to the tenets of nationalist ideology and perpetuate the nationalist imaginary routinely. Any disruptions or objections encountered during this daily enactment of nationalism may potentially lead to a shift across the delineated boundary between ally and adversary within the political domain. Despite attempts by the nationalist narrative to forestall dissent by offering concessions in the form of rewards and punishments, this approach proved unsuccessful. Numerous political and social actors highlighted the oppression, violence, and inequality engendered by nationalist ideology and practices, and offered alternative perspectives for perceiving the political realm and divergent pathways for political subjectivity. These dual paths of dissent emerged as primary modes of contestation against the nationalist construct.

This critique sometimes manifested in the formation of new political subjectivities and alliances rooted in alternative political frameworks. For instance, in the 1991 general elections,

9
Gladio was conceived as a secret resistance network within the NATO countries in order to prevent socialist/communist activities. See: Ferraresi, F., & Castagna, J. (1992). A secret structure codenamed Gladio. *Italian Politics*, 7, 29-48.

10
Bora, T. (1995). *Milliyetçiliğin Kara Baharı* [The Dark Spring of Nationalism]. İletişim Publishing.

the coalition between the Social Democratic Populist Party and the People's Labour Party proposed an alternative political paradigm by uniting a social democratic party with the Kurdish political movement, albeit without success. In tandem with the development of alternative political discourses and frameworks, opposition to the nationalist paradigm has manifested on a broader scale through struggles for rights and recognition in the 1990s. Organizations such as the Human Rights Association (IHD) have played a prominent role in spotlighting the infringements upon rights perpetuated by nationalist and securitized discourses and practices. They have also spearheaded the requisite political and legal efforts to identify and rectify these rights violations.

The recent history of Turkey is characterized by the persistent endeavor of nationalist discourses to frame contemporary political conflicts, including migration, poverty, and authoritarianism, within the thematic confines of nationalist vocabulary, such as security, survival, and unity. It is evident that the burgeoning authoritarianism in Turkey draws inspiration from the historical repertoire of the nationalist political imagination. This stark continuity between the nationalism prevalent in the 1990s and the present discourse and practices of nationalist politics in Turkey serves as a poignant reminder of the imperative to recognise and highlight the injustices that are being perpetrated. It underscores the necessity of envisaging and cultivating egalitarian and emancipated modes of comprehending, interpreting, and reshaping the political landscape.

ME Hale, në këtë intervistë do të doja të përqendrohesha në njërën nga punët e juaja: “Unë Njoh Njerëz të Tillë II”.

“Unë Njoh Njerëz të Tillë” është një cikël i punëve. Prodhuar në vitin 1992, “Unë Njoh Njerëz të Tillë”, përbëhet nga një maskë gazi e gjetur e varur brenda një kafazi, një qilim i derës i ngjitur për zorrën e maskës që varet poshtë, dhe një tas metalik me ujë nën pjesën e qilimit në formë zemre. “Unë Njoh Njerëz të Tillë II”, prodhuar po të njëjtin vit për Bienalen e 3-të të Stambollit, përbëhet nga figurina bronzi, të njohura si Priapuse, të renditura në mur në formën e hënës dhe yjeve, që të kujtojnë flamurin turk, dhe të rrethuara nga yje të përbërë nga Priapuse sërish, si dhe tre figurina majmunësh. Ndryshe nga punët tjera të këtij cikli, “Unë Njoh Njerëz të Tillë II” i referohet një komuniteti më shumë se një individi. A mund të na tregoni pak për procesin e kësaj pune, mjedisin politik të Turqisë në fillim të viteve 1990, dhe arsyet që ju shtynë në realizimin e kësaj pune?

HT Në vitin 1992, njëkohësisht kam realizuar dy punë. Njëra ishte “Unë Njoh Njerëz të Tillë II”, të cilën e prodhova për Bienalen e 3-të të Stambollit me ftesë të Vasıf Kortun, dhe tjetra ishte “Nevojshmëria e Ajrit”, të cilën e realizova me ftesë të Zerrin İren Boynudelik, e cila atëherë ishte përgjegjëse për aktivitetet kulturore në Bibliotekën Atatürk. Të dy instalacionet u fokusuan në dilemat e vazhdueshme politike dhe kulturore në Turqi, dhe në politikat shtypëse dhe diskriminuese shtetërore që vazhduan të zbatoheshin pavarësisht ndryshimeve në pushtet. Sidoqoftë, “Nevojshmëria e Ajrit” dhe “Unë Njoh Njerëz të Tillë II” ishin mjaft të ndryshme nga njëra-tjetra për sa i përket qasjes së tyre ndaj temës dhe gjuhës vizuale që përdora.

“Unë Njoh Njerëz të Tillë II”, e cila është një instalacion në mur, përdor një gjuhë të drejtpërdrejtë dhe lehtësisht të kuptueshme, e cila është ndoshta fillimisht zbavitëse, por në të njëjtën kohë mjaft e ashpër. Kompozicioni i Priapuseve dhe tre figurinave të majmunëve në mur përçon një mesazh të qartë për një pushtet që dominimin e ka të bazuar në dhunë dhe kërcënime, dhe një shoqëri e detyruar të heshtë dhe të zgjedh pasivitetin si kundërpërgjigje. Figurinat e Priapusit i kisha hasur mes artikujve turistikë që shiteshin në Pazarin e Madh. Statuja origjinale e Priapusit, e ekspozuar në Muzeun Arkeologjik të Efesit, ka një kokë që, edhe pse jo aq në madhësi të ekzagjeruar sa organi i tij gjenital, është mjaft e madhe në raport me trupin e tij. Fakti që koka e zotit të fertilitetit ishte tkurrur ndjeshëm kur u kthye në një objekt turistik që shitet në Pazarin e Madh, më dukej se ishte një përmbledhje e politikave shtetërore shtypëse dhe të bazuara në dhunë që po vazhdonin në Turqi, veçanërisht në Anadollin juglindor. Figura e Priapusit ishte shkëputur nga kuptimi i të qenit zot i fertilitetit dhe ishte shndërruar në një mishërim vizual të frazës “duke menduar me penisin e tij”.

ME Përveç të qenit simbol i fertilitetit dhe bollëkut, siç e përmendët ju, ne e dimë se historikisht Priapus është cilësuar edhe si zot i mbrojtjes dhe shërimit, madje edhe i teprisë dhe ekstravagancës. Kur u shndërruan në objekte suvenire, jo vetëm që u zhvesh nga ky kuptim, por u hoqën edhe mjekrat, që përfaqësonin intelektin dhe mençurinë. Do të doja të pyesja edhe për tre figurinat e majmunëve të përfshira në instalacion, të cilat i keni përdorur si objekte si në “Nevojshmëria e Ajrit”, prodhuar në të njëjtin vit, ashtu edhe në punët që keni prodhuar në vitet në vijim. Nëse nuk gabohem, për herë të parë u bë pjesë e praktikës tuaj në vitin 1992, dhe herë pas here kthehesh te tre majmunët si pikë referimi. A mund të flisni shkurtimisht për marrëdhënien tuaj me tre majmunët, dhe këmbënguljen tuaj për të i përdorur ata gjatë tridhjetë viteve të fundit?

HT Po, i kam përfshirë tre figurinat e majmunëve në punë të ndryshme ndër vite. Kjo ishte nga domosdoshmëria; i rikthehesha tre figurinave të majmunëve sa herë që durimi im vihej në provë nga heshtja e publikut përballë shtypjes politike. Secilën herë, e kam përdorur si mënyrë për të reflektuar mbi situatën ekzistuese dhe si nxitës. Me fjalë të tjera, nuk kam menduar kurrë ta ripërdor këtë figurë në prodhimin tim artistik si tipar dallues. Këtu dua të theksoj se kritika ndaj heshtjes nuk do të thotë se unë nënvlerësoj apo shpërfill shqetësimet personale, politike dhe ekonomike

që qëndrojnë pas pasivitetit të individëve. Është thjesht një vlerësim i situatës dhe një inkurajim për të qenë të zëshëm. Frika, lodhja dhe plogështia që rezultojnë nga presioni i vazhdueshëm i pushtetit dhe hierarkisë si në shkallë lokale ashtu edhe globale po bëhen gjithnjë e më të përhapura. Megjithatë, me akumulimin e këtij presioni ndër shekuj dhe me shpejtësinë e komunikimit sot, besoj se kjo situatë po i afrohet një pike pa kthim.

ME Siç e përmendët në fillim, "Unë Njoh Njerëz të Tillë II" bazohet në politikat shtypëse dhe diskriminuese të shtetit. Do të doja të kthehesha në periudhën kur ju e realizuat këtë punë. Vitet 1990 ishin ndër periudhat më të errëta në politikën e Turqisë. Shumë nga krimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera gjatë asaj kohe nuk janë zbardhur, dhe ndjekja e drejtësisë nga individët dhe familjet vazhdon edhe sot.

Si ishin vitet 1990 për ju? Ndoshta do të ishte edhe më mirë të fokusoheshim specifikisht në gjysmën e parë të viteve 1990, kur edhe u prodhua kjo punë. Më lejoni të theksoj gjithashtu se ju keni përfunduar studimet e magjistraturës në Mbretëri të Bashkuar në vitin 1988 dhe jeni kthyer në Turqi. Gjatë asaj periudhe keni krijuar kontakte të ngushta me Shoqatën për të Drejtat e Njeriut (IHD) të sapo themeluar dhe me Asamblenë Qytetare të Helsinkit.

HT Ekziston një marrëdhënie e drejtpërdrejtë midis mungesës së sqarimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën dhe vazhdimësisë së shkeljeve të tilla. Unë isha në të tridhjetat gjatë viteve 1990, dhe ndonëse përjetimi i politikave shtypëse të asaj periudhe brenda rrethit tim mund të kishte qenë 'i ri' për mua, unë isha gjithashtu e vetëdijshme se ky ishte një mekanizëm i vazhdueshëm shtetëror. Meqë kisha mundësinë të përjetoja një mjedis arsimor jashtë Turqisë gjatë studimeve të mia të magjistraturës në Mbretërinë e Bashkuar, mbaj mend që u befasova dhe u preka thellësisht nga rëndësia dhe respekti që i jepej individit, kufijve personal dhe nevojave të tyre. Respekti vlerësohet edhe në Turqi, por shpesh mbetet nominal dhe rrallëherë duket i sinqertë. Duke pasur parasysh që paraprakisht kisha marrë një arsim të privilegjuar në Turqi (Kolegji Amerikan i Izmirit, Universiteti Boğaziçi, dhe Universiteti Mimar Sinan), dallimi ishte edhe më i theksuar. Prandaj, mund të them se këndvështrimi im për Turqinë, në nivel politik, shoqëror dhe individual, u bë shumë më i qartë pas kthimit nga Mbretëria e Bashkuar, veçanërisht nga pozicioni im si grua.

Më 9 shtator 1989, IHD organizoi një koncert të titulluar *Human Rights Now, Not Tomorrow!* [Të Drejtat e Njeriut Tani, Jo Nesër!] në Teatrin e Hapur në Stamboll[1]. Ishte një lloj hapi jozyrtar i serisë së koncerteve me titull *Human Rights Now!* organizuar nga Amnesty International. Dega e Amnesty International në Turqi nuk ishte themeluar ende, por Özlem Dalkıran, e cila më vonë do të bëhej një nga themelueset e saj, dhe anëtarët e grupit "Mozaik", të cilët performuan në koncert, ishin miqtë e mi. Në ditën e koncertit, unë realizova një skulpturë me Eren Akay.

Kam pasur kontakt me Asamblenë Qytetare të Helsinkit gjatë periudhës së përgatitjes dhe ekspozimit të "Vëzhgimi i Denjë i Vdekjeve: Bosnja-Hercegovina" (1993). Kur vizitova kampin e refugjatëve Kırklareli, i raportova Asamblesë së Qytetarëve të Helsinkit për presionin administrativ dhe shkeljet e të drejtave të njeriut kundër refugjatëve boshnjakë që menaxhmenti i kampit po përpiqej të fshihte. Puna u ekspozua në Bibliotekën e Grave dhe Qendrën e Informacionit, e cila u themelua në vitin 1990 dhe është muzeu i vetëm i grave në Turqi.

1
Në vitin 1988, Amnesty International programoi një cikël koncertesh në 20 vende nën titullin "Human Rights Now!" për të tërhequr vëmendjen mbi 40-vjetorin e miratimit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Koncerti "Human Rights Now, Not Tomorrow!" në Stamboll, i organizuar si një protestë kundër kufizimeve në burgje dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, të shkaktuara nga "August 1 Circular" [Qarkorja e 1 Gushtit], u frymëzua nga ky cikël koncertesh e transmetuar nga Korporata Turke e Radios dhe Televizionit. Koncerti ishte planifikuar të mbahej më 27 gusht 1989, megjithatë, ai u refuzua me arsyetimin se ishte "i synuar për të formuar opinion publik dhe për të fituar mbështetje për një temë të caktuar në vend të performancës muzikore". Aplikimi i bërë më 3 shtator nga Dega e Shoqatës për të Drejtat e Njeriut në Stamboll, organizatorë të koncertit, gjithashtu u refuzua. Koncerti u mbajt më 9 shtator me pjesëmarrjen e muzikantëve, artistëve dhe aktorëve të njohur.

Menjëherë pas ekspozitës, vendosa instalacionin "Vëzhgimi i Denjë i Vdekjeve: Bosnja-Hercegovina" në Qendrën e Kongreseve të Ankarasë Altınpark për të u ekspozuar së bashku me Asamblenë e 3-të Ndërkombëtare të Qytetarëve të Helsinkit.

ME "Nevojshmëria e Ajrit", "Unë Njoh Njerëz të Tillë II", "Vëzhgimi i Denjë i Vdekjeve: Bosnja-Hercegovina"... të gjitha të prodhuara në fillim të viteve 1990. Emëruesi i përbashkët i këtyre punëve është se ato janë të lidhura ngushtë me politikat shtetërore dhe regjimin e vazhdueshëm shtypës të Turqisë në atë kohë. Për më tepër, që të trija i referohen valës në rritje të nacionalizmit brenda vendit gjatë asaj periudhe. Mes gjithë kësaj, shembuj të organizatave që për mision kanë të drejtat e njeriut u shfaqën në peizazhin e shoqërisë civile. IHD dhe Asambleja Qytetare e Helsinkit janë dy prej tyre.

Në një mjedis të tillë, menjëherë pas hapjes së Bienales së 3-të të Stambollit, "Unë Njoh Njerëz të Tillë II" u bë subjekt i dy proceseve të ndryshme gjyqësore. E para ishte për fyerje të flamurit turk dhe e dyta për fyerje të simboleve të kombit turk. Përveç këtyre, keni pranuar telefonata kërcënuese. A mund ta përshkruani këtë proces nga fillimi në fund? Gjithashtu, më duhet të pyes, a ju ka shkuar ndonjëherë në mendje që një punë e juaja e ekspozuar do të bëhej lëndë e një procesi gjyqësor dhe se një kërcënim i tillë është i mundshëm?

HT Bienalja e 3-të e Stambollit u mbajt midis 17 tetorit dhe 30 nëntorit 1992. Gjithçka filloi me një artikull të botuar nga Beşir Ayvazoğlu në gazetën "Türkiye" nën titullin "Bisedat e së hënës" më 26 tetor 1992. Ai e përfundoi artikullin e tij me një ton kërcënues në lidhje me punën time, duke përmendur emrin tim. Ai tha diçka si, "artistët që prodhojnë punë të tilla duhet të jenë të përgatitur për atë që mund të u ndodhë". Puna ime është ekspozuar gjatë gjithë periudhës së bienales pa asnjë incident. Megjithatë, një person i quajtur Nevin Arifoğlu, as pa e parë punën, por duke ndjerë mllef dhe zemërim si grua turke pasi lexoi artikullin e Beşir Ayvazoğlu, ajo bëri një ankesë në Zyrën e Prokurorisë Publike të Eyüp, gjë që çoi në thirrjen time dhe dhënien e një deklarate. Më pas, unë u ndoqa penalisht për shkelje të nenit 7 të ligjit nr. 2893 për flamurin turk në Gjykatën e Parë Civile për Juridiksion Penal në Eyüp më 3 nëntor 1992. Meqenëse ky nen i ligjit i referohej specifikisht flamurit fizik të Turqisë dhe nuk kishte asnjë flamur turk në përmbajtjen e punës time, u anulua nga juridiksioni. Kështu që dosja ime u dërgua në Gjykatën e Dytë Penale të Shkallës së Parë të Eyüp më 10 qershor 1993.

Në gjyqin e mbajtur në Gjykatën e Dytë Penale të Shkallës së Parë të Eyüp më 10 nëntor 1993, unë u gjykova për fyerje të simboleve të kombit turk. Sipas mendimit të gjykatës, megjithëse instalacioni në mur fillimisht i ngjante një gjysmëhëne dhe një ylli, kishte edhe yje të tjerë, dhe qëllimi kryesor ishte përfaqësimi i universit dhe nënshtrimi i grave nga burrat. Nuk ka pasur asnjë qëllim përbuzjeje, andaj dhe nuk kishte asgjë kriminale përsa i përket aspekteve formale të punës, ndaj jam shpallur e pafajshme.

Gjatë këtij procesi përafërsisht një vjeçar, u ngacmova dhe u shqetësova nga telefonatat në telefonin tim të shtëpisë. Edhe pse telefoni im nuk ishte i regjistruar me emrin Hale Tenger, natyrisht që ishte shqetësuese që ata mund të më gjenin. Në atë kohë, kishte vetëm telefona të shtëpisë, dhe regjistrat e telefonit përfshinin gjithashtu adresën e banimit të atij numri. I gjithë procesi ishte shumë stresues për mua, por mendoj se momenti më shqetësues ishte pasi përfundoi bienalja, kur të gjitha punët e ekspozuara në ndërtesën Feshane u deinstaluan dhe paketuan, dhe vetëm puna ime nuk u lejua të hiqej nga muri për shkak se ishte "element kriminal".

Mendova se puna mund të bëhet subjekt i një padie. Kjo është arsyeja pse u konsultova me disa njerëz të cilëve u besoja, të cilët besoja se kishin qëndrime politike dhe përvojë në sistemin gjyqësor. Në atë kohë Gjykatat e Sigurisë së Shtetit[2] ishin më të frikshmet. Disa njerëz më paralajmëruan se mund të përfundoja në një Gjykatë të Sigurisë së Shtetit. Mendova se kisha marrë masa që të i shmangesha një padie duke rritur numrin e yjeve në kompozicion.

2
Sipas Kushtetutës së vitit 1982, junta e atëhershme ushtarake krijoi Gjykatat e Sigurisë së Shtetit [*Devlet Güvenlik Mahkemeleri - DGM*] për të gjykuar rastet që përfshijnë krime kundër sigurisë së shtetit, dhe krimin e organizuar. Në një sërë rastesh, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar se prania e gjyqtarëve ushtarakë në Gjykatat e Sigurisë së Shtetit është shkelje e parimeve të gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ECHR).

ME E di që “Unë Njoh Njerëz të Tillë II” nuk është ekspozuar në Turqi që nga viti 1992. Kjo tregon se kur bëhet fjalë për unitetin dhe integritetin e kombit dhe përfaqësimin e tij në Turqi, kufizimet, thënë thjesht, nuk ndryshojnë me kalimin e kohës. Së fundmi, do të doja të pyesja, a ndikoi kjo përvojë e tmerrshme në praktikën tuaj në ndonjë mënyrë?

HT Procesi ishte i frikshëm, por pas Bienales së 3-të të Stambollit, nga një kthesë e fatit, u ftova në Bienalen e 4-të të Stambollit, dhe e shfrytëzova këtë mundësi të përgjigjem në mënyrën time duke prodhuar një instalacion tjetër me titull “Nuk dolëm jashtë; ishim gjithmonë nga jashtë/ Nuk hymë brenda; ishim gjithmonë nga brenda”[3]. Rrethova një kabinë druri të rojës që gjeta në katin e dytë të ndërtesës Antrepo (hapësirë ekspozuese e bienales) me një gardh me tela dhe gjemba. Dritaret dhe muret e brendshme të kabinës së rojës ishin të mbuluara me faqe kalendari me peizazhe të natyrës si lule, livadhe dhe tufa bagëtish, duke sugjeruar se personi që qëndronte në kabinën e rojeve nuk donte të shihte jashtë. Për të hyrë, duhej të kalohej nëpër një vendkalim të ngushtë që të kujtonte kampet e përqendrimit. Në kontrast me pjesën e jashtme, pjesa e brendshme e kabinës së rojës ishte plot ngjyra dhe në radio dëgjoheshin këngë popullore gazmore. Ngjita dy distinktivë antike të xhaketave me smalt në skajin e një prej dritareve. Njëra kishte një gjysmëhënë dhe një yll dhe tjetra kishte një kokë dashi të pozicionuar midis dy thikave të kryqëzuara. Distinktivi i dytë u vodh që në orët e para të hapjes! E kërkova shumë por nuk e gjeta më, edhe pse mendova se mund ta gjeja duke pasur parasysh se mund të i përkiste një shoqate kasapësh ose ndonjë institucioni të ngjashëm. Në fund të fundit, në mënyrën time me këtë punë thashë atë që kisha për të thënë në përgjigje ndaj procesit gjyqësor.

Nuk isha burgosur, por cili ishte dallimi midis të qenit brenda ose jashtë burgut?

Para protestave të Gezit, që shpërthyen në fund të majit 2013, mora pjesë në një ekspozitë të titulluar *Envy, Enmity, Embarrassment* [Zilia, Armiqësia, Turpi], të kuruar nga Emre Baykal, e cila u hap në janar dhe zgjati deri më 7 prill. Instalacioni që prodhova për ekspozitën trajtonte shtypjen politike dhe dhunën në Turqi, dhe përfshinte një përzgjedhje të mijëra imazheve që kisha mbledhur nga arkivat e shtypit, që nga Pogromi i Stambollit i 6-7 shtatorit 1955. Të gjitha imazhet u shtypën në filma me rreze X dhe u ekspozuan në panele të dritës që ngjanin me negatoskopë gjigantë, të vendosur në një korridor labirint. Rreshti i parë i këtij instalacioni, të cilin e titullova “Unë Njoh Njerëz të Tillë III”, u shfaq përgjatë fasadës së xhamit të Arterit (vendndodhja e mëparshme e institucionit), i dukshëm për të gjithë këmbësorët që kalonin nëpër Beyoğlu. Për më tepër, imazhet në rreshtin e parë ishin të ngjarjeve aktuale politike për të cilat nuk raportohej në faqet e brendshme të gazetave për shkak të presionit dhe cenzurës. Kështu, u menduam nëse do të rrjedhin probleme nga kjo, por asgjë nuk ndodhi. Kjo ka qenë gjithmonë tipike në Turqi: kurrë nuk e din saktësisht se çfarë do të shkaktojë ose nuk do të shkaktojë probleme.

Kjo intervistë është realizuar në formë të shkruar midis tetorit 2023 dhe majit 2024.

3
Titulli i punës është citim nga një poezi e Edip Cansever.









ME Hale, in this interview, I would like to focus on one of your works: *I Know People Like This II*.

I Know People Like This is a series. Produced in 1992, *I Know People Like This*, consists of a found gas mask hanging inside a cage, a doormat attached to the mask's hose hanging downwards, and a metal bowl of water under the heart-shaped fringe of the mat. *I Know People Like This II*, produced the same year for the 3rd Istanbul Biennial, consists of brass figurines, known as Priapuses, arranged on the wall in the form of the moon and stars, reminiscent of the Turkish flag, and surrounded by stars made up of Priapuses again, as well as three monkey figurines. Unlike the first work of the series, *I Know People Like This II* refers to a community rather than an individual. Can you tell us about the process of this work a little bit, the political environment of Turkey in the early 1990s, and the reasons that led you to produce this work?

HT In 1992, I simultaneously produced two works. One was *I Know People Like This II*, which I produced for the 3rd Istanbul Biennial at Vasıf Kortun's invitation, and the other was the *Necessity of Air*, which I realized on the invitation of Zerrin İren Boynudelik, who was then in charge of the cultural activities at the Atatürk Library. Both installations focused on the ongoing political and cultural dilemmas in Turkey, and on the oppressive and discriminatory state policies that continued to be implemented despite changes in power. However, *Necessity of Air* and *I Know People Like This II* were quite different from each other in terms of their approach to their subject and the visual language I used.

I Know People Like This II, which is a wall installation, uses a direct and easily understandable language, which is perhaps initially amusing but at the same time quite harsh. The composition of the Priapuses and three monkey figurines on the wall delivers a clear statement about the dominance of power based on violence and threats, and the society forced into silence and passivity in response.

I had come across the Priapus figurines among the tourist items sold in the Grand Bazaar. The original Priapus statue, located in the Ephesus Archaeological Museum, has a head that, although not as exaggeratedly large as its genitalia, is quite large in proportion to its body. The fact that the fertility god's head had shrunk considerably when it turned into a tourist object sold in the Grand Bazaar seemed to me to be a summary of the oppressive and violence-based state policies ongoing in Turkey, particularly in southeastern Anatolia. The Priapus figure had drifted away from being a god of fertility and had turned into a visual embodiment of the phrase "thinking with his dick."

ME Besides being the symbol of fertility and abundance, as you mentioned, we know that historically Priapus has also been described as the guardian of protection and healing, and even of excess and extravagance. When turned into souvenir objects, not only were these representations stripped away, but their beards, representing intellect and wisdom, were also removed. I'd also like to ask about the three monkey figurines included in the installation, which you have used as an object both in *Necessity of Air*, produced in the same year, and in the works you produced in the following years. If I'm not mistaken, it first became a part of your practice in 1992, and from time to time you return to the three monkeys as a reference point. Could you briefly talk about your relationship with the three monkeys, and your persistence in using them over the past thirty years?

HT Yes, I have used the three monkey figures in various works over the years. This was out of necessity; I revisited the three monkey figures whenever my patience was tested by the public's silence in the face of political oppression. Each time, I used it both as a means of reflecting the existing situation and as a trigger. In other words, I never thought of reusing this figure in my artistic production as a signature. Here I want to emphasize that criticizing silence does not mean that I underestimate or disregard the personal, political, and economic concerns behind individuals' passivity. It is merely an assessment of the situation and an encouragement to speak out. Fear, weariness, and fatigue resulting from the continuous pressure of

power and hierarchy on both a local and global scale are becoming increasingly widespread. However, with the accumulation of this pressure for centuries and the speed of communication today, I believe this situation is approaching a breaking point.

ME As you mentioned in the beginning, *I Know People Like This II* is based on oppressive and discriminatory state policies. I would like to return to the period when you produced this work. The 1990s was one of the darkest periods in the politics of Turkey. Many of the crimes and human rights violations committed during that time have not been clarified, and the pursuit of justice by individuals and families continues even today.

What was the 1990s like for you? It might be even better to focus specifically on the first half of the 1990s, when this work was also produced. Let me also note that you completed your Master's degree in UK in 1988 and returned to Turkey. During that period, you established close contact with the newly founded Human Rights Association (IHD), and with the Helsinki Citizens' Assembly.

HT There is a direct relationship between the lack of clarification of past human rights violations and the continuation of such violations. I was in my thirties during the 1990s, and while experiencing the oppressive policies of that period within my own circle might have been 'new' for me, I was also aware that this was an ongoing state mechanism. When I had the opportunity to experience an educational environment outside of Turkey during my Master's studies in the UK, I remember being surprised and deeply affected by the importance and respect given to the individual, their boundaries, and their needs. Respect is valued in Turkey as well, but it often remains nominal and rarely feels sincere. Considering that I had received a privileged education in Turkey beforehand (Izmir American College, Boğaziçi University, and Mimar Sinan University), the difference was even more striking. Therefore, I can say that my perspective on Turkey, politically, socially, and individually, became much clearer after returning from the UK, especially as a woman.

On September 9th, 1989, IHD organized a concert titled *Human Rights Now, Not Tomorrow!* at the Open-Air Theater in Istanbul.[1] It was a kind of the unofficial leg of the concert series titled *Human Rights Now!* organized by Amnesty International. Amnesty International's branch in Turkey had not yet been established, but Özlem Dalkıran, who would later become one of its founders, and the members of the band Mozaik, who performed at the concert, were my friends. On that concert day, I produced a sculpture with Eren Akay.

I had contact with the Helsinki Citizens' Assembly during the preparation and exhibition period of *Decent Deathwatch: Bosnia-Herzegovina* (1993). When I visited the Kırklareli Refugee Camp, I reported to the Helsinki Citizens' Assembly about the administrative pressure and human rights violations against Bosnian refugees that the camp management was attempting to cover up. The work was exhibited at the Women's Library and Information Center, which was founded in 1990, and is the only women's museum in Turkey. Immediately after the exhibition, I set up the *Decent Deathwatch: Bosnia-Herzegovina* installation at the Ankara Altınpark Congress Center to be exhibited alongside the 3rd International Helsinki Citizens' Assembly.

ME *Necessity of Air*, *I Know People Like This II*, *Decent Deathwatch: Bosnia-Herzegovina*... all produced in the early 1990s. The common denominator of these works is that they are closely related to the state policies and the ongoing oppressive regime of Turkey at that time. Additionally, all three of them reference the rising wave of nationalism within the country during that period. Amidst all this, examples of rights-based organizations emerged. IHD and the Helsinki Citizens' Assembly are two of them.

In such an environment, shortly after the opening of the 3rd Istanbul Biennial, *I Know People Like This II* became the subject of two separate lawsuits. The first one was for insulting the Turkish flag, and the second was for insulting the symbols of the Turkish nation. In addition to these, you received threatening phone calls. Could you describe this process from beginning to end? Also, I have to ask, did it ever occur to you that an exhibited work of yours would become the subject of a lawsuit and that such a threat would exist?

HT The 3rd Istanbul Biennial took place between October 17th and November 30th, 1992. It all started with an article published by Beşir Ayvazoğlu in the newspaper *Türkiye* under the title "Monday Conversations" on October 26th, 1992. He concluded his article with a threatening tone regarding my work, mentioning my name. He said something like, "artists who produce such works should be prepared for what might happen to them". My work was exhibited throughout the biennial period without any incidents. However, a person named Nevin Arifoğlu, without even seeing the work but feeling outrage and anger as a Turkish woman upon reading Beşir Ayvazoğlu's article, called in a complaint about it to the Eyüp Public Prosecutor's Office, which led to me being called in and giving my statement. Subsequently, I was prosecuted for violating Article 7 of Law No. 2893 on the Turkish Flag at the Eyüp 1st Peace Court of Criminal Jurisdiction on November 3rd, 1992. Since this article in the law referred specifically to the physical Turkish flag, and there was no Turkish flag in the content of my work, it was ruled out of jurisdiction. So my file was sent on to the Eyüp 2nd Penal Court of First Instance on June 10th, 1993.

In the trial held at the Eyüp 2nd Penal Court of First Instance on November 10th, 1993, I was tried for insulting the symbols of the Turkish nation. In the opinion of the court, although the wall installation initially resembled a crescent and star, there were also other stars, and the main intent was the representation of the universe and the subjugation of women by men. There was no intention of contempt, and therefore, there was no crime in terms of the elements of the work, so I was acquitted.

During this process of approximately one-year, I was harassed and disturbed by phone calls to my home phone. Although my phone was not registered under the name Hale Tenger, it was naturally unsettling that they could find me. At that time, there were only home phones, and phone directories also included the address information of that number.

The whole process was very stressful for me, but I think the most upsetting moment was after the biennial ended, when all the works at the Feshane building were packed and sent away, and only my work was not allowed to be taken off the wall due to it being a "criminal element."

I thought that it might become the subject of a lawsuit. That's why I consulted with a few people I trusted, who I believed had political stances and experience in the judiciary system. At that time, the State Security Courts[2] were the most frightening. Some people warned me that I could end up in a State Security Court. I thought I had taken precautions by increasing the number of stars in the composition.

ME I know that *I Know People Like This II* has not been exhibited in Turkey since 1992. This indicates that when it comes to the unity and integrity of the nation and its representation in Turkey, restrictions, to say the least, do not change over the years. Lastly, I would like to ask, did this terrifying experience affect your practice in any way?

HT The process was frightening, but after the 3rd Istanbul Biennial, by a twist of fate, I was invited to the 4th Istanbul Biennial, and I took the opportunity to respond in my own way by producing another

1
In 1988, Amnesty International programmed a series of concerts in 20 countries under the title "Human Rights Now!" in order to draw attention to the 40th anniversary of the adoption of the Universal Declaration of Human Rights. The "Human Rights Now, Not Tomorrow!" concert in Istanbul, organized as a protest against prison restrictions and human rights violations brought on by the "August 1 Circular," was inspired by this concert series broadcast by the Turkish Radio and Television Corporation. The concert had been planned to be held on August 27th, 1989, however, it was rejected on the grounds that it was "aimed at forming public opinion and winning support on a certain topic rather than the performance of music." The application filed on September 3rd by the Human Rights Association Istanbul Branch, the organizers of the concert, was also rejected. The concert was held on September 9th with the attendance of well-known musicians, artists and actors.

2
Under the 1982 Constitution, the then-military junta established State Security Courts [*Devlet Güvenlik Mahkemeleri - DGM*] to try cases involving crimes against the security of the state, and organized crime. In a number of cases the European Court of Human Rights has found the presence of military judges in the State Security Courts to be a violation of the fair trial principles set out in Article 6 of the European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms (ECHR).

installation titled *We didn't go outside; we were always on the outside/We didn't go inside; we were always on the inside*.[3] I surrounded a wooden guardhouse I found on the second floor of the Antrepo building (the biennial venue) with a barbed wire fence. The windows and interior walls of the guardhouse were covered with calendar pages depicting nature scenes like flowers, meadows, and grazing flocks, suggesting that the person using the guardhouse did not want to see outside. To enter, one had to walk through a narrow passage reminiscent of concentration camps. In contrast to the outside, the interior of the guardhouse was colorful, and cheerful folk songs could be heard on the radio. I attached two enamel antique lapel pins to the edge of one of the windows. One had a crescent and star, and the other had a ram's head between two crossed daggers. The second pin was stolen within the first hours of the opening! I searched for it a lot but never found it again, even though I thought I could find it considering it might belong to a butchers' association or some similar institution. Ultimately, with this work, I said what I had to say in response to the lawsuit process in my way. I hadn't gone inside, but what was the difference between inside and outside?

Before the Gezi Protests, which broke out at the end of May 2013, I participated in an exhibition titled *Envy, Enmity, Embarrassment*, curated by Emre Baykal, which opened in January and ran until April 7th. The installation I produced for the exhibition dealt with political oppression and violence in Turkey, and included a selection of thousands of images I had collected from press archives, going back to the Istanbul Pogrom of September 6–7, 1955. All the images were printed on X-ray films and displayed on lightbox panels resembling giant negatoscopes, arranged in a labyrinthine corridor. The first row of this installation, which I titled *I Know People Like This III*, was displayed along the glass facade of Arter (the old location of the institution), visible to all pedestrians passing by in Beyoğlu. Moreover, the images in this first row were of current political events that could not be covered in newspapers' inner pages due to pressure and censorship. So, we wondered if we would get into trouble, but nothing happened. This has always been typical in Turkey: you never know exactly what will cause or not cause trouble.

This interview was conducted in written form between October 2023 and May 2024.

3
The title of the work is a quote from a poem by Edip Cansever.

Pesëmbëdhjetë vjet më parë unë botova një ese të shkurtër me titull “Rrënjët Kulturore të Artit Bashkëkohor në Kosovë”, duke propozuar tezën se arti bashkëkohor në Kosovë që u shfaq pas mijëvjeçarit të ri ishte një formacion i pabarabartë. Arti bashkëkohor u zhvillua nga e para dhe artistët e rinj larguan shikimin nga e gjithë trashëgimia e historisë së artit. Piktura, skulptura, ideja e ateliesë, socializmi dhe nacionalizmi, në fakt gjithçka që mbante erë “modernizmi” shihej si kulturë aliene. Arti bashkëkohor i Kosovës filloi si një kulturë me të vërtetë postmoderne, në një mënyrë që postmodernizmi përkufizohet si “vetëasgjësim” i trashëgimisë. Kjo kishte gjithashtu konotacione pozitive, pasi premtoi dhe u dha rrugë fillimeve të reja. Ky formacion ishte një përzierje e egër e mosbesimit spontan ndaj institucioneve shtetërore dhe frymës së ekzaltuar të etikës subkulturore. Kjo periudhë nuk zgjati shumë, por shumë punë të rëndësishme arti u prodhuan nisur nga kjo dialektikë. Këtu, në këtë ese, unë do të vështroj mënyrat se si ndodhi ky ndryshim karshi institucionalizimit dhe profesionalizimit. Duke shqyrtuar narrativën zyrtare nga dokumente publike, do të rindërtoj këtë moment që shënoi këtë ndryshim dhe do të deshifroj disa nga kontradiktat e tij që vazhdojnë të jenë me ndikim në artin bashkëkohor në Kosovë.

Me projektin *Relations* [Lidhjet], të iniciuar nga Fondacioni Gjerman i Kulturës, arti bashkëkohor në Kosovë u hodh drejt profesionalizmit. Duke zgjatur nga viti 2003 deri në vitin 2006, *Relations* u konceptua si një bashkëpunim midis Gjermanisë dhe Evropës Lindore. Krahas Prishtinës, ka mbështetur edhe skenën e artit në Kishinev, Sofje, Sarajevë, Varshavë, Zagreb dhe Lubjanë. Krahu i Prishtinës ishte emëruar *Missing Identity* [Identiteti i Munguar] dhe është drejtuar nga Instituti i Artit Bashkëkohor Exit në Pejë, në bashkëpunim me Laboratorin për Arte Pamore dhe Qendrën për Studime Humanistike “Gani Bobi”, në Prishtinë. Drejtuesit e projektit ishin Sokol Beqiri, Erzen Shkololli dhe Mehmet Behluli, figura ende aktive në skenën artit të Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe, ekspozitat kanonike ballkanike të Harald Szeemann dhe René Block u realizuan, të dyja në vitin 2003, po ashtu e shumënjohura Bienalja e Stambollit në 2005, kuruar nga Charles Esche dhe Vasıf Kortun, ku ndër punët e ekspozuara ishin edhe katër video të Jakup Ferrit. Me fjalë të tjera, projekti *Missing Identity* ka ndodhur në kohën më interesante të artit bashkëkohor të Kosovës dhe ka ndihmuar në institucionalizimin dhe solidifikimin e dinamikave mjaft të lirshme të artit të ri në zhvillim. Për të nxjerrë mësime nga këto hapa fillestarë, duhet të shikojmë botimin që dokumenton këto procese. *Leap into the City: Cultural Positions, Political Conditions. Seven Scenes from Europe* [Kërcimi në Qytet: Pozicionet Kulturore, Kushtet Politike. Shtatë Skena nga Evropa], u botua nga DuMont Literatur und Kunst Verlag në vitin 2006 dhe u redaktua nga Katrin Klingan dhe Ines Kappert.

Kapitulli mbi Kosovën titullohet *‘Waiting for the State’* [Në Pritje të Shtetit] dhe seksioni më i gjatë i tij është një transkript i redaktuar i tryezës së rrumbullakët e titulluar *‘A State of Waiting’* [Në Gjendje Pritjeje]. Në debat, Shkëlzen Maliqi propozon një tezë se arti bashkëkohor në Kosovë është një nga hapësirat ende të hapura për “mendimin kritik”, duke sugjeruar se arti bashkëkohor është një praktikë që transcendon kufijtë kulturorë të etno-nacionalizmit. Maliqi u shpreh se arti bashkëkohor në Kosovë është ndoshta “mbetja e fundit e një hapësire kulturore jugosllave”. Kjo është një jehonë e tezës së Maliqit nga vitet e tetëdhjeta se hapësira kulturore shqiptare mund të ekzistojë në Jugosllavi në formën e saj “dyvalente” – kulturalisht shqiptare, ideologjikisht jugosllave.

Kjo, në fund të viteve tetëdhjetë, evoluoi në një ideologji ‘disidente’ që argumentonte për formacione politike shumëvalente në një demokraci shumëpartiake. Në thelb, ky ishte një argument për një identitet kulturor që nuk e ka bazën në komb, por është i konstruktuar mbi bazat e kulturës bashkëkohore. Më parë, roli i kësaj kulture progresive i ishte dhënë teatrit dhe letërsisë, herë pas here pikturës. Në fund të viteve nëntëdhjetë me ekspozitën “Përtej”, të kuruar nga Maliqi, arti bashkëkohor u bë një formë dominante kulturore që i përgjigjej këtij ndryshimi ideologjik.

Arti bashkëkohor, sipas këtij këndvështrimi, ishte pjesë e një rezistence më të gjerë kulturore që për qëllim kishte të u shmangej thjeshtëzimeve dhe kundërshtojë pozicionin e të qenit zëdhënës i politikave mbizotëruese nacionaliste dhe shtetërore. Ky opsion alternativ në Kosovë, pas kalimit në mijëvjeçarin e ri, ishte një "modernizim i dështuar"; një qorrsokak kulturor i artikuluar ndryshe nga njerëzit që kontribuonin në diskutim. Enver Hasani, asokohe rektor i Universitetit të Prishtinës, i cili nuk mori pjesë në tryezën e rrumbullakët, por kontribuoi me esenë "Konflikti për Kosovën është konflikt për territor", aty ai shkroi se: "Ajo që i duhet Kosovës, në thelb, është një projekt postmodern që do të prezantonte qytetarët e Kosovës me mundësi të barabarta në Evropë dhe tjetërkund". Për Hasanin, ky tjetërkund ishin Shtetet e Bashkuara [të Amerikës], të cilat e konsiderojnë Kosovën si pjesë të tyre të "agjendës së sigurisë".

Kalimi nga modernizmi i brishtë i Maliqit i bazuar në supra-nacionalizmin jugosllav drejt stabilitetit të garantuar nga globalizmi euroatlantik, në shumë mënyra detektohet në bifurkacionet e ndërlikuara të artit bashkëkohor të Kosovës. Artistë të rangjeve të ndryshme, nga socialist-realizmi i frymëzuar nga etno-nacionalistët e deri te eklekticizmi post-Duchampian, iu përgjigjen këtij ndryshimi; ose duke skulpturuar Bill Clinton si figurat në pikturat e Abdurrahim Buzës, ose duke prezantuar video klipe të këngëtarëve etno-pop si një punë e gatshme [*readymades*] në muret e bardha të galerive.

E dalur nga dekada e kontrollit ushtarak shtetëror (vitet tetëdhjetë) dhe aparteidi (vitet nëntëdhjetë), Kosova në vitet e 2000-ta, nga prizmi i artit bashkëkohor, dukej si një vend i hapur ndaj mundësive të shumta. Psikoanalisti dhe teoricienti Branimir Stojanović, përkufizoi këtë veçori si "singularitet" dhe identifikoi në dinamikat e "pa shtetësisë" të skenës kulturore të Kosovës të ardhmen e formave artistike. Me fjalë të tjera, Kosova, në thelbin e saj *ishte* art bashkëkohor, dhe kishte potencial për të ridefinuar të ardhmen e kësaj praktike. Nga këndvështrimi i sotëm, pas Manifestës 14 fitimprurëse në Prishtinë dhe Bienales Autostrada në Prizren të menaxhuar me sukses – të dyja produkte të negociatave dhe kompromiseve të pafundme – ky pretendim për "singularitetin" duket si një ide filozofike puritane. Ky kalim, nga arti bashkëkohor idealist dhe semi-autonom te praktika e ndërmjetësuar nga ana e institucioneve, nuk ndodhi brenda natës.

Aspekti më tregues i diskutimit të organizuar nga projekti *Relations* në Prishtinë, ishte çështja e dukshmërisë. Sokol Beqiri, një artist i cili ishte drejtor i projektit *Missing Identity*, deklaroi se galeria që po drejtonin në Pejë (Galeria Exit, e drejtuar me mbështetjen e projektit) ishte "i vetmi dyqan që nuk shet asgjë", duke adresuar pozicionin e turbullt dhe të padukshëm të artit bashkëkohor në qytetet e vogla të Kosovës. Nga ana tjetër, Erzen Shkololli, drejtor i projekteve artistike në kuadër të *Missing Identity*, i cili po ashtu programonte Galerinë Exit, mendonte se ata tashmë po zinin një vend të rëndësishëm në shoqëri, dhe shprehet: "Ne ishim artistë dhe u bëmë drejtorë, kuratorë, organizatorë të ekspozitave, e kështu me radhë". Që nga viti 2005, kur u bë kjo deklaratë, Shkololli ishte drejtor i dy galerive kombëtare të artit (Prishtinë dhe Tiranë) dhe aktualisht është duke kuruar edicionin e ardhshëm të Bienales Autostrada në Prizren (2025).

Migjen Kelmendi, vetë aktiv në promovimin e këtij ndryshimi, shkroi tekstin kryesor në kapitullin e librit mbi Prishtinën duke u shprehur si në vijim: "Kosova mbetet ende një shoqëri që është e imagjinuar jo sa duhet". Migjeni u përpoq të i përgjigjej realitetit kompleks të Kosovës duke eksperimentuar me "identitete" të reja. Në të përjavshmen "Java" të cilën e redaktonte, ai botoi një sërë esesh dhe intervistash mbi identitetin kosovar, i cili, sipas tij, ishte i mbipërkufizuar nga "mungesa e fjalorit të nevojshëm". Propozimi për të imagjinuar një "identitet supra-etnik të Kosovës" të pavarur nga "projektet anakronike të shtetit etnik shqiptar", siç duket nuk shkoi aq mirë në vitet 2000. Bajram Rexhepi, kryeministri i parë i Kosovës, të cilin Kelmendi e citon, në vitin 2002 propozoi termin "kosovar" për "arsye praktike", që duhet të nënkuptojë "që shumica është shqiptare dhe të tjerët janë pakicë".

Sot, të gjitha këto minoritete (veçanërisht serbët dhe turqit) dhe shumica, janë duke u kapur më fort për identitetet e tyre etnike. Njëzet vjet më vonë, nacionalizmat nuk pushuan së përcaktuari logjikën kulturore të Republikës së re të Kosovës; përkundrazi, ajo u bë referencë edhe më e rëndësishme në përballjen me konjukturën aktuale. Plani i Shkëlzen Maliqit që parashihte diskurset e artit bashkëkohor si të vetmet "hapësira të hapura për mendim kritik", nuk është përmbushur. Edhe sot, është Maliqi, herë pas here unë dhe disa 'shkrimtarë tjerë të rinj', që na kërkohet të kontribuojmë në katalogët e artit. Diskursi është ende në sferën e Jugosllavisë, por realiteti diku tjetër.

Si erdhi deri te kjo? Në një tryezë të rrumbullakët diskutimi të vitit 2005, *'A State of Waiting'*, Andreas Ernst, korrespondent në Beograd i *Neue Zürcher Zeitung*, një gazetë nga Zvicra, shprehu skepticizmin e tij rreth bashkëkohësisë së artit bashkëkohor të Kosovës: "Mua më dukeni shumë apolitik". Ajo që Ernst kishte në mendje ishte se artistët dhe kuratorët kosovarë, veçanërisht ata që merrnin pjesë në diskutim, nuk u angazhuan rreth çështjeve urgjente të trashëgimisë serbe në Kosovë ("kisha ortodokse e papërfunduar" në kampusin universitar të Universitetit "Hasan Prishtina"), nacionalizmi, dështimet organizative ("keni një problem me vetë-promovimin"), gjithëpërfshirja ("pjesëmarrja e artistëve apo kritikëve nga Serbia dhe Maqedonia") dhe "pajtimi". Erzen Shkololli i është përgjigjur kësaj duke thënë se ata "duan të bëjnë art" e jo politikë, duke shtuar se "ka aq pak para në dispozicion" për të bërë art. Ky debat është ende i pazgjidhur. Pyetja nëse varësia ekonomike është e lirë nga politika dhe mënyrat në të cilat dinamikat komplekse dhe të pabarabarta të kapitalizmit kontribuojnë në formimin e artit bashkëkohor mbetet ende pa përgjigje.

Para projektit *Missing Identity*, i financuar dhe i inicuar nga Fondacioni Gjerman i Kulturës, mbështetësit e vetëm të skenës së artit në Kosovë ishin Pro Helvetia dhe Programi për Kulturë i Fondacionit Soros. Projekti kishte siguruar vende pune me rroga, infrastrukturë për ligjerata dhe ekspozita, aktivitete botuese dhe duke ftuar ligjërues mysafirë. Nuk është çudi që aspekti kryesor i tryezës së rrumbullakët të diskutimit u përqëndrua në çështje të infrastrukturës, menaxhimit, administrimit dhe nevojës për të depërtuar në institucionet publike dhe shtetërore. Branislava Andjelković, drejtorja e atëhershme e Muzeut të Artit Bashkëkohor në Beograd, duke folur nga përvoja e tyre e suksesshme në Serbi (në përfshirjen e sektorit të OJQ-ve të artit bashkëkohor në një institucion shtetëror), u sugjeroi artistëve dhe kuratorëve nga Kosova që të "zhvillojnë infrastrukturën e duhur [...] për të depërtuar në institucionet shtetërore" (në rast se ministri i kulturës kërkon një program prej tyre).

Ky proces që kërkon "edukim të mëtejshëm të menaxherëve kulturorë", nuk ishte në agjendën e projektit *Relations*, por nëpërmjet burokracisë që e kishte bërë të domosdoshme projekti, ndihmoi në forcimin e kuptimësisë së artit bashkëkohor si diçka që lidhet thelbësisht me aftësitë e administrimit. Kjo lidhje mes artit që është i lirë nga kërkesat politike dhe kërkesat e kapitalizmit të administruar është nën-teorizuar në rastin e Kosovës.

Hulumtimet në këtë drejtim mund të japin një pasqyrë të re mbi parakushtet e ideologjisë së artit bashkëkohor, duke u mbështetur fuqishëm në kuptimësinë se demokracia dhe liria e shprehjes janë të barasvlershme me sundimin e *laissez faire* kapitalizmit.

Një pyetje tjetër që ra në sy gjatë diskutimit ishte rreth arkivave të cilat do të mund të ndihmonin në historizimin e skenës së artit në Kosovë. Branislava Andjelković këmbënguli se vetëpërfaqësimi dhe vetëhistorizimi është kyç në ndërtimin e një skene të artit lokal. Ajo sugjeroi, madje me mjaft optimizëm, se Muzeu i Artit Bashkëkohor në Beograd mund të i sigurojë Prishtinës dëshmi koherente nga shtypi i kohës mbi artin e shekullit të njëzetë që u zhvillua në ish-Jugosllavi. Trashëgimia ekzistuese e artit bashkëkohor të Jugosllavisë supra-kombëtare (që bashkon Lubjanën, Zagrebin, Sarajevën, Beogradin, Shkupin, Novi Sadin) mund të plotësojë identitetin jo-partikularist të artit. Me këto njohuri Prishtina mund të mësonte bashkëkohësinë.

E kuptueshme, ky sugjerim nuk u ndoq nga akterët e artit bashkëkohor në Kosovë; madje as çështja e arkivave nuk u mor seriozisht. Për sa i përket vetë-historizimit, legjitimiteti institucional nëpërmjet vetëpërfaqësimit mori njëfarë vrulli. Është një anekdotë mjaft përshkruese, e treguar nga Shkololli, për Gianfranco Politin, themeluesin e *Flash Art*, të cilit drejtori i atëhershëm i Galerisë Kombëtare të Kosovës i tregoi një katalog të "artistit mainstream" vendas, pas së cilës Politi e anuloi vizitën e tij në Prishtinë. Kjo mundësi e humbur për Kosovën më vonë u zëvendësua me katalogë të dizajnuar më mirë dhe u kompenzua me ekspozita të artit botëror, por çështja e arkivave të historisë së re të artit ende mbetet pikëpyetje.

Sot, mund të studiohet lehtësisht arti bashkëkohor i Kosovës gjatë Jugosllavisë socialiste, por është pothuajse e pamundur të bëhet edhe një hulumtim rudimentar për artin bashkëkohor pas vitit 2000. Madje as revista "Arta", e botuar nga projekti *Missing Identity* në Prishtinë, si dhe botimi 600-faqësh me përmbledhje tekstesh *Leap into the City*, nuk janë në dispozicion në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, dhe kjo madje nuk është në dispozicion as në arkivat institucionale të projektit. Kjo është arsyeja pse çdo historizim i artit bashkëkohor të Kosovës kërkon rishkrimin e tij.

Relating to Projects

Sezgin Boynik

Fifteen years ago I published a short essay titled ‘Cultural Roots of Contemporary Art in Kosovo,’ proposing the thesis that contemporary art in Kosovo emerged after the new millennia had an uneven formation. Contemporary art emerged from scratch, and the young artists turned their heads away from the entirety of art historical heritage. Painting, sculpture, the idea of the studio, socialism, and nationalism — in fact everything that smelled of “modernism” was seen as alien culture. Kosovo contemporary art started as a truly postmodern culture, in a way that postmodernism is defined as the “self-annihilation” of heritage. This had positive connotations too, as it promised and enforced new beginnings. This formation was a wild mixture of spontaneous distrust towards the state institutions and the exalted spirit of subcultural ethics. This period did not last long, but many great artworks emerged from this dialectic. Here in this essay, I will look at the ways in which the shift towards institutionalization and professionalization happened. By looking at the official narrative of the public documents, I will reconstruct this shift, and decipher some of its contradictions, which continue to be influential in contemporary art in Kosovo.

With the project *Relations*, initiated by the German Cultural Foundation, contemporary art in Kosovo leaped into professionalism. Lasting from 2003 to 2006, *Relations* was conceived as a cooperation between Germany and Eastern Europe. Alongside Prishtina, it also supported scenes in Chișinău, Sofia, Sarajevo, Warsaw, Zagreb and Ljubljana. The Prishtina arm was named *Missing Identity* and it was run by the Contemporary Art Institute, Exit in Peja, in cooperation with the Laboratory for Visual Arts and the Gani Bobi Center for Humanistic Studies in Prishtina. The people leading the project were Sokol Beqiri, Erzen Shkololli and Mehmet Behluli, names that are still active in the Kosovo art scene.

During this period, the canonical Balkan shows of Harald Szeemann and René Block took place, both in 2003, and the famous Istanbul Biennial, curated by Charles Esche and Vasıf Kortun, in 2005, which included four videos by Jakup Ferri. In other words, the *Missing Identity* project happened in the most exciting days of Kosovo contemporary art, and it helped to institutionalize and solidify the rather loose dynamics of the emerging new art. In order to draw lessons from these initial steps, we should look at the publication documenting these processes. *Leap into the City: Cultural Positions, Political Conditions. Seven Scenes from Europe,* was published by DuMont Literatur und Kunst Verlag in 2006, and was edited by Katrin Klingan and Ines Kappert.

The chapter on Kosovo is titled ‘Waiting for the State’ and its longest section is an edited transcript of the roundtable discussion titled ‘A State of Waiting’. In the debate, Shkëlzen Maliqi proposes a thesis that contemporary art in Kosovo is one of the spaces still open to “critical thought,” suggesting that contemporary art is a practice transcending the cultural confines of ethno-nationalism. Maliqi claims that contemporary art in Kosovo is perhaps “the last remnants of a Yugoslav cultural space.” This is an echo of Maliqi’s thesis from the eighties that Albanian cultural space could exist in Yugoslavia in its “bi-valent form” — culturally Albanian, ideologically Yugoslav.

This, in the late eighties, evolved into a ‘dissident’ ideology arguing for multi-valent political formations in a multi-party democracy. In essence, this was an argument for non-nationalist cultural identity, constructed through permanency of contemporary culture. Earlier, the role of this progressive culture was relegated to theater and literature, or occasionally to painting. At the end of the nineties, with the exhibition *Beyond*, curated by Maliqi, contemporary art became a dominant cultural form corresponding to this ideological shift.

Contemporary art, according to this view, was part of a larger cultural resistance that sought to escape simplifications and opposed to being a mouthpiece for prevailing nationalist and

state policies. This alternative option in Kosovo, after the turn of the millennium, was a "failed modernization"; a cultural dead-end expressed differently by people contributing to the discussion. Enver Hasani, then the rector of the University of Prishtina, who did not participate to the roundtable but contributed with an essay 'The Conflict for Kosova is a Conflict for Territory,' claimed that "What Kosova needs, in essence, is a postmodern project that would present Kosovo's citizens with an equal opportunity in Europe and elsewhere in the world." For Hasani, this elsewhere was the United States, which considers Kosova as part of its "security agenda."

The shift from Maliqi's fragile modernism based on Yugoslav supra-nationalism towards the stability guaranteed by Euro-Atlantic globalism, is in many ways detected in the complicated bifurcations of Kosovo's contemporary art. Artists from all ranks, from socialist-realism inspired ethno-nationalists to post-Duchampian eclecticism, responded to this change; either by sculpting a Bill Clinton that looked like Abdurrahim Buza's paintings, or placing ethno-pop singers as readymade works into white cube galleries.

Emerging from decades of militarized state control (the eighties) and apartheid (the nineties), Kosovo in the 2000s looked, in the vision of contemporary art, like a place open for all possibilities. Psychoanalyst and theoretician Branimir Stojanović, marked this distinctiveness as the "singularity" and saw in the "stateless" dynamics of Kosovo's cultural scene the future of art forms. In other words, Kosovo, in its essence, *was* contemporary art, and it had the potential to redefine the future of this practice. From today's perspective, after the lucrative Manifesta 14 in Prishtina and the successfully-managed Autostrada Biennial in Prizren — both products of endless negotiations and compromises — this claim for the "singularity" seems like a puritan philosophical idea. This change, from idealistic and semi-autonomous contemporary art to the practice mediated by institutions, didn't happen overnight.

The most indicative aspect of the discussion organized by the *Relations* project in Prishtina, was the question of visibility. Sokol Beqiri, the artist who was director of the *Missing Identity* project, claimed that the gallery they were running in Peja (Gallery Exit, run with the support of the project) was the "only store that doesn't sell anything," addressing the obscure and invisible position of contemporary art in small towns in Kosovo. On the other hand, Erzen Shkololli, director of art projects within *Missing Identity,* who was also programing the Gallery Exit, felt that they are already occupying a crucial part of society, and states, "We were artists and we became directors, curators, exhibition organizers, and so on." Since 2005, when this statement was made, Shkololli was director of two national art galleries (Prishtina and Tirana) and is currently curating a forthcoming edition of the Autostrada Biennial in Prizren (2025).

Migjen Kelmendi, himself active in promoting this shift, wrote a main text in the Prishtina chapter of the book claiming that "Kosovo still remains a society that is unimagined enough." Migjen sought to respond to the complex reality of Kosovo by experimenting with new "identities." In the weekly newspaper *Java* he was editing he published a series of essays and interviews on the Kosovar identity, which was, according to him, overdetermined

by the "lack of the necessary vocabulary." The proposal to imagine a "supra-ethnic Kosova identity" independent from the "anachronistic projects of the Albanian ethnic state," did not go as smoothly as it looked in the 2000s. Bajram Rexhepi, the first prime minister of Kosovo, whom Kelmendi cites, proposed in 2002 the term "Kosovar" for "practical reasons," which should imply "that the majority is Albanian and others are minorities."

Today, all these minorities (especially Serbs and Turks) and the majority, are clinging more steadily onto their ethnic identities. Twenty years later, nationalisms did not cease to determine the cultural logic of the new Kosovo Republic; instead it became even more of a reference when dealing with the actual conjuncture. Shkelzen Maliqi's plan to envision contemporary art discourses as the only "space open for critical thought," was not fulfilled. Still today, it is Maliqi, occasionally me, and a couple of other 'younger writers', who are asked to contribute to art catalogs. The discourse is still in the realm of Yugoslavia, but reality somewhere else.

How did this come about? Already in the 2005 roundtable discussion 'A State of Waiting', Andreas Ernst, a Belgrade correspondent of *Neue Zürcher Zeitung*, a newspaper from Switzerland, remarked his skepticism about the contemporaneity of Kosovo contemporary art: "To me you seem very apolitical." What Ernst had in mind was that Kosovo artists and curators, especially those taking part in the discussion, did not engage with pressing questions regarding the issue of Serbian heritage in Kosovo (the "unfinished Orthodox church" on the campus of Hasan Prishtina University), nationalism, organizational failures ("you have a self-marketing problem"), inclusion ("participation of artists or critics from Serbia and Macedonia"), and "reconciliation." Erzen Shkololli responded to this by saying that they "want to do art" not politics, adding that "there is so little money at stake" when doing art. This debate is still unresolved. The question whether economic dependence is free from politics and the ways in which complex and uneven dynamics of capitalism have contributed to the formation of contemporary art still remains unanswered.

Until the *Missing Identity* project, which was financed and initiated by the German Cultural Foundation, the only supporters of the Kosovo art scene were Pro Helvetia and the Soros Foundation Culture Program. The project had secured salaried jobs, and infrastructure for lectures and exhibitions, publishing activities, and inviting guest lecturers. No wonder the important part of the roundtable discussion evolved around questions of infrastructure, management, administration and the need to penetrate to the public and state institutions. Branislava Andjelković, the then director of the Contemporary Art Museum in Belgrade, talking from their successful experience in Serbia (in incorporating the NGO sector of contemporary art into a state institution), suggested artists and curators from Kosovo "develop the right infrastructure [...] in order to penetrate into the state institutions" (in case the minister of culture asks for their programme).

This process requiring "further education of cultural managers," was not on the agenda of the *Relations* project, but through the bureaucracy it had necessitated, helped to solidify the understanding of contemporary art as something intrinsically related to the skills of administration. This connection between art that is free of political demands and the requirements of administered capitalism is under-theorized in the case of Kosovo. Research in this direction could give some fresh insight on the preconditions of the ideology of contemporary art, much relying on the understanding that democracy and freedom of expression is equivalent to the reign of *laissez faire* capitalism.

Another question that stood out in the discussion was about the archives that would help to historicize the Kosovo art scene. Branislava Andjelković insisted that self-representation and self-historicization is a key to building a local art scene.

She suggested, rather too optimistically, that the Contemporary Art Museum in Belgrade could provide Prishtina with comprehensive press clippings on the twentieth century art that took place in former Yugoslavia. The existing contemporary art heritage of supra-national Yugoslavia (uniting Ljubljana, Zagreb, Sarajevo, Belgrade, Skopje, Novi Sad) could supplement the non-particularist identity of the art. With this knowledge Prishtina could learn contemporaneity.

Understandably, this suggestion was not followed by the actors of contemporary art in Kosovo; neither was the question of archives taken seriously. In regards to self-historicization, institutional legitimacy by self-representation acquired some momentum. Telling is an anecdote, told by Shkololli, about Gianfranco Politi, founder of *Flash Art*, to whom the then director of the National Gallery of Kosovo showed a catalog of a local "mainstream artist," after which Politi canceled his visit to Prishtina. This missed opportunity for Kosovo was later replaced with better designed catalogs and compensated with global art exhibitions, but the question of archives of the recent history of art still remains.

Today, one can easily study Kosovo contemporary art during the period under socialist Yugoslavia, but it is almost impossible to conduct even rudimentary research on contemporary art after 2000. Even the magazine *Arta*, published by the *Missing Identity* project in Prishtina, and the 600 hundred-pages *Leap into the City* reader are unavailable in the National Library of Kosovo, and indeed even in the institutional archives of the project itself. This is the reason why each historicization of Kosovo contemporary art requires its own rewriting.

EK Nurhan, kur e ke realizuar videon një-kanalësh “Flamuri” në vitin 2005, ke qenë duke jetuar dhe punuar në Zelandë të Re. Megjithatë, kjo punë në shumë mënyra ka rezonuar dhe ka qenë në dialog me çështjet identitare kombëtare që preokuponin Kosovën në atë kohë. A mund të diskutosh më detajisht çfarë të ka shtyer të realizosh këtë punë?

NQ Këtë video e kam realizuar shumë aksidentalisht. Kam dashur të i fotografoj shputat e mia edhe thashë, “Ah, dua të i lëvizi pak”. Tashmë e kisha një video me shputa ashtu duke i lëvizur. Kështu fillova të realizoj video dhe ta vë në funksion të tyre trupin tim. Mendoja që trupi ishte... në fakt shputat ishin shumë interesant, më dukeshin shumë të çuditshme, i kisha gishtat e gjatë e... dhe fillova të luaj me këtë fakt. Mandej sa i përket trupit, unë kurrë nuk e kam pëlqyer trupin tim, nuk më ka pëlqyer asgjë në lidhje me dukjen time. Më vonë më është dukur me rëndësi të çlirohem nga kjo, ta vë trupin në diskutim, të shoh çfarë bëhet nga ky trup kur hidhet në shqyrtim. Por sa i përket punës “Flamuri”, aty ndodhi diçka tjetër, pasi që me këtë punë u shkëputa nga hulumtimet e mia artistike dhe mora një kahje të re.

EK Në çfarë mënyre?

NQ Në njëfarë mënyre ka qenë moment kur unë kam kërsitë edhe kam thënë nuk po më intereson çfarë kam punuar deri tani dhe çfarë lidhje mund të ketë ky projekt me punët paraprake. Në atë periudhë, unë isha në studimet e magjistraturës dhe kam pasur një profesor me të cilin i diskutoja punët e mia. Atij i thashë: “A din çka? Do i lë anash të gjitha që jam duke punuar tani dhe dua të bëj këtë”. Kam shkuar tek daja i Majlinda Hoxhës, i cili ka qenë përfaqësues i komunitet shqiptar në Zelandë të Re, dhe prej tij e kam marrë flamurin kombëtar. Partnerit tim që e kisha në atë kohë i thashë: “Hajde me mua”. Ai më ka vozitur me makinë. Jemi ndalur në një vend dhe ai i ka lëshuar dritat e makinës edhe unë e kam kënduar himnin. Himni ndërpritet në video, mirëpo pse e kam ndërprerë është rrëfim në vete. Arsyeja pse ndërpritet himni është sepse neve na afrohet një makinë tjetër dhe unë frikësohem. Aty ndërpreva edhe xhirimin. Mora flamurin dhe e mbulova trupin me të. Ka qenë një skenë shumë qesharake. Makina kaloi edhe më pas e kam xhiruar edhe një herë sepse nuk më ka pëlqyer kualiteti i dritës. Kjo video është realizuar në ambient të jashtëm.

EK Ambient i jashtëm? Në video nuk vërehet çfarë lloj hapësire është.

NQ Kjo ka qenë në orën 1:00 të natës, 1:00 ose 2:00 të natës, kështu diçka. Mandej u mendova: “Hajt edhe një herë ta xhiroj, sepse ndriçimi nuk po më pëlqen. Ndriçimi ma i mirë...” E kam xhiruar edhe një version të kësaj video, të njëjtën me ndriçim më të mirë, por nuk më ka pëlqyer. Sa isha në dhomën e montazhës thashë: “Jo, kjo me ndriçim më të paktë më pëlqen më shumë”, edhe e kam prerë aty. Kam thënë, “Dua ta kthej mbrapsht”. E kisha përdorur këtë teknikë me një video tjetër, “Red Tape” (2004). Kisha eksperimentuar me video imazhe duke i kthyer mbrapsht. Dhe kështu ndodhi që fillova ta prezantoja “Flamurin” si video.

EK Pse në ambient të jashtëm kur ke mundur të shfrytëzosh studion e shkollës apo ndonjë hapësirë tjetër? Më trego më shumë, pse ky vendim?

NQ Ideja gjithnjë ka qenë që kjo video të realizohet jashtë. Jo në studio, nuk ka mundësi! Studio kurrë nuk ka qenë opcion. Kam dashur të jetë në një ambient të jashtëm. Edhe më herët kisha realizuar projekte tjera jashtë. Ato projekte merrshin trajtën e ritualeve që i performoja në ambientin e jashtëm dhe natën. Ka qenë një vendim shumë intuitiv, nuk ka qenë ndonjë vendim mirë i menduar. Jo, jo, intuitiv, këtu dua ta këndoj himnin, jashtë, me flamur dhe nudo. Kaq!

EK A mund të diskutosh më shumë vënien e trupit në funksion të kuptim-bërjes në videon “Flamuri”?

NQ Kur kam qenë në shkollë të muzikës, na e kanë mësuar himnin kombëtar. Dhe arsimtarja na tha: “Shiko, ju e mësuat himnin, por mos e këndoni në rrugë”. Kishte frikë që ne do ta këndojmë në publik. E ke parasysh që kur fëmijët e mësojnë një këngë kanë dëshirë ta këndojnë në rrugë. Edhe për mua kjo ka qenë interesant, se ne jemi të rritur disi

me këtë ndalesë: “Jo, shuj, shuj, shuj, shuj”. Kur thojnim: “Kosova Republikë! Demokraci!” Të rriturit na tërhiqnin vërejtjen: “Mos gabo me e thënë me zë!” Të shprehësh diçka që lidhet me identitetin kombëtar ka pasur konsekuenca dhe kjo ka qenë një frikë e thellë gjatë kohës së regjimit të Millosheviqit në Kosovën e viteve të ‘90-ta.

Së këndejmi, babai na ka rritur me shumë nocione turpëruese rreth trupit. “Jo se marre. S’bon!” Të ka shikuar nga një pozicion kritik, nuk të ka thënë direkt që diçka është e turpshme. Ndërsa unë është dashur ta kuptojë vet çfarë është e turpshme rreth veprimeve të mia. Por ajo ka qenë mënyra e tij se si ai ka menduar që është duke na mbrojtur neve. Ne ishim katër motra, andaj për te ishte brengë: “Më duhet të i mbrojë ato”. Në atë kohë, përderisa situata politike ishte e tensionuar, ai nuk na ka lejuar të dalim jashtë shtëpisë shumë. Kështu që, unë në një mënyrë kam trashëguar shumë shqetësime të cilat nuk ishin të miat. Unë kam qenë shumë e vogël dhe e ngarkuar me këto probleme. Pra, kjo ka qenë një lloj ngarkese për mua. Ndalesat ndodh që nuk të janë komunikuar direkt nga ana e babait, por ti e ke nënkuptuar nga motrat që nuk lejohet të bëhen gjëra të caktuara.

Nuk e di në cilin moment fillojmë të krijojmë vetëdije mbi trupin tonë dhe si fillojmë të ndiejmë turp. Kjo ju ndodh shumë njerëzve, por për mua kjo ka ndodhur në një moshë të hershme. Disi si më vinte turp, madje kur gjinjtë filluan të më dukeshin, unë kisha turp. Më vonë më është manifestuar kjo dëshirë të dal nudo edhe të këndoj himnin edhe të marr flamurin. Ka qenë një kundërpërgjige ndaj të gjitha këtyre përvojave të hershme që kanë prodhuar këtë ndjenjë të turpit.

EK Kur e ke realizuar këtë punë, a ke konsideruar vetën feministe? A mund ta përshkruash lehtësinë apo vështirësinë për ta definuar vetën feministe në atë kohë?

NQ Në atë kohë unë mendoja: “Feminizmi? Meh”. Nuk e kuptojsha, jo që nuk e kuptojsha, por nuk ishte ky motivi. Nuk ka qenë kurrë në radarin tim të flas për këtë punë si punë feministe. Jo që kisha diçka kundër feminizmit, sepse shumë nga inspirimet e mia vinin nga arti feminist. Kur shikoj pas, kam përcjellur punën e Marina Abramović, Pipilotti Rist, e shumë të tjerave. Ka qenë një ekspozitë në Auckland mbi artin feminist dhe unë kam qenë shumë interesuar në atë ekspozitë. Çdo të dytën ditë shkoja ta shihja atë ekspozitë. Merrja me vete ditarin tim dhe shkruaja përshtypjet e mia dhe kështu i ekspoloroja këto punë. Kështu që për mua arti feminist, as atëherë këtë ekspozitë nuk e shihja si feministe. Madje as arti feminist nuk më dukej shumë feminist. Me sa duket kam pasur paragjykime rreth termit “feminist”, që për mua ka pasur kuptimin e asaj që je grua e hidhur dhe i urren burrat dhe gjëra të ngjashme. Andaj, unë nuk identifikohesha si e tillë.

EK Si e ke perceptuar?

NQ Mua më tërhiqte rrugëtimi i një gruaje e cila është e aftë të përkthej dhimbjen dhe vështirësitë e saj në një punë arti. Për mua ky aspekt ka qenë shumë domethënës. Kur një grua arrinë të ju mbijetojë të gjitha situatave për të cilat ka qenë e mësuar të mos i hulumtojë. “S’duhet, s’duhet, s’duhet!” Dhe shumë nga gratë artiste i kanë tejkaluar kufizimet e parapërcaktuara shoqërore përmes praktikës së tyre artistike. Dhe kjo për mua ka qenë diçka që shumë e kam vlerësuar. Unë poashtu kam dashur të jem në gjendje ta bëj këtë përmes punës time. Por, kjo dëshirë nuk ka ardhur nga vetëdija: “Dua të bëj art feminist”. Ky nuk ka qenë kurrë motivimi sa më duket, dhe kjo ndodh sepse i kam perceptuar gjërat në një mënyrë

tjetër. Në hulumtimin tim artistik, mua më kanë interesuar ritualet dhe aspekti kryesor ka qenë rrugëtimi im shpirtëror. Por nuk mundësh ta ndash njërën nga tjetra, sepse si grua ti ke një rrugëtim shpirtëror dhe ke bezditë e jetës së përditshme, por ke edhe rrëfimin tënd të cilin duhesh ta thurësh dhe i cili është vetëm i yti.

EK Të bësh rrugëtimin tënd si grua, shumë shpesh nevojitet të zhbësh mendësinë patriarkale. Dhe këtu mendoj që hyn feminizmi, ndodh që nuk vjen direkt nga qëndrimet e tua politike feministe, por vjen nga përvoja në të cilën kalon dhe nga ajo që duhesh të zhbësh për të krijuar hapësirë për praktikën tënde artistike. Por, a mundësh pak më gjerësisht të më tregosh se si është lexuar kjo punë në Kosovë?

NQ Çfarë lexohej në punën time në kontekstin e Kosovës, tashmë ishte pranishme në realitetin e këtij konteksti. Andaj edhe them që kjo punë u zbarkua mirë në këtë kontekst. U lexua në të më shumë se që kisha anticipuar. Definitivisht më shumë. Kanë lexuar në të më shumë se që është e pranishme në atë punë, posaçërisht momenti në video ku unë e ndërprej himnin. Gjë që unë atë gjestikulim nuk e kisha bërë me paramendim. Unë tashmë ta tregova edhe arsyen pse. Në një mënyrë, ajo ka qenë me vetëdëshirë, por arsyeja pse vendosi që himni të këndohet mbrapsht në momentin kur vendosi, ka qenë vendim estetik. Më pëlqente si tingllonte himni i kënduar mbrapsht.

Mënyra se si lexohej puna në Kosovë, unë e shihja më shumë si... sikur kur një i huaj vjen në kontakt me një popullsi etnike të një vendi, mirëpo që edhe vet përpiqet të kuptojë vendin e vet. Ashtu edhe unë i qasesha, isha ajo kosovarja që në një mënyrë isha shkëputur nga vet ajo shqiptarja që ishte rritur në Kosovën e viteve 1990, dhe i kishte ato sentimente kombëtare, ndërsa unë e kisha vënë në shqyrtim edhe atë.

Për këtë arsye më është dukur interesant realizimi i “Flamurit” sepse e trajton edhe atë shkëputje prej vetës. Si punë, pozicionohet disi nga jashtë, mirëpo vjen edhe nga brenda. Mirëpo, nuk është brenda për ato arsye për të cilat ka marrë leximin, definitivisht jo. Por, unë nuk e kam pasur shumë problem atë çështje, sepse kjo vetëm sa ia zhvillonte dimensionet asaj pune. Dhe kjo pjesë gjithnjë më është dukur interesant.

EK Aq më pak që nuk mund të kontrollosh kuptimin e punës tënde.

NQ Jo, nuk mundësh dhe kjo është e mrekullueshme që nuk mundësh të bësh diçka të tillë. Si artiste pamore, nuk mundesh me qenë e pavëmendshme ndaj këtij fakti, duhesh me qenë e pamençur të mendosh: “Unë këtë dua të komunikoj. Tash ju më falni, por nëse e kuptoni kështu atëherë unë po tërhiqem dhe nuk e mbështes leximin tuaj”. Nuk funksionon ashtu. Ti krijon diçka dhe ajo zbarkohet në kontekst ashtu si zbarkohet. Kjo punë ka zbarkuar kështu dhe është në rregull. Ndoshta është dashur që unë të potencoj më shumë këtë aspektin feminist, por unë nuk kam mundur dhe nuk dua të jem jo e sinqertë për këtë pjesë.

EK Jo, jo, dhe unë nuk kam pritje nga ti të bësh diçka të tillë.

NQ Po, e di, andaj edhe jemi duke e zhvilluar këtë bashkëbisedim. Por, po e them, e kam pasur pak stresues këtë formulim. Në njëfarë forme kisha përshtypjen që njerëzit kanë nevojë të dëgjojnë këtë nga unë, që unë duhet të u jap një formulim të tillë mbi punën. Gjë që nuk ka qenë ashtu dhe ky është leximi im më i sinqertë.

EK Kur puna “Flamuri” është prodhuar në vitin 2005, flamuri kombëtar shqiptar dhe himni kanë qenë shënjuesit kryesorë të identitetit për shqiptarët e Kosovës. Kjo punë konfronton një version të nacionalizmit përmes të cilit ne kemi konceptuar identitin kombëtar para pavarasisë së vitit 2008. Pas prezantimit të kësaj pune në Kosovë çfarë dimensione tjera ka zhvilluar?

NQ Këtë punë e kam realizuar gjatë studimeve të mia të magjistraturës në Zelandë të Re. Mirëpo, nuk e kam treguar si punë mëvete, nuk ka qenë e prezantuar kjo punë gjatë magjistraturës, sepse nuk ka qenë pjesë e hulumtimeve të mia artistike asokohe. Andaj, shpesh e them që me këtë punë disi jam shkëputur nga hulumtimi në të cilin isha e thelluar dhe flisja për të. Kështu që, përmes kësaj pune

prezantova diçka krejtësisht tjetër. Shkurt pas diplomimit në vitin 2006, unë erdha në Kosovë. Gjatë kësaj vizite fillova të hulumtojë edhe skenën lokale të artit, por çfarë më bëri përshtypje ishte mënyra se si puna ime "Flamuri" lexohej këtu. Kur ia tregova punën Mehmet Behlulit dhe Shkëlzen Maliqit, më vonë edhe Erzen Shkololli, ata kishin një vlerësim të lartë për këtë punë, sepse për ta komunikonte mirë me kontekstin lokal. Këtu në Kosovë kishte kontekst për këtë punë. Atëherë edhe unë fillova të mendoj se si "Flamuri" rezononte me temat më të mëdha të këtij vendi, siç është feminizmi dhe nacionalizmi.

EK Teknologjia e kamerës ka qenë më e qasshme asokohe dhe disi më lehtë ka qenë të bëhesh prodhuese e imazheve lëvizëse. Sa i zhvilluar ka qenë video arti në kontekstet në të cilat ke punuar si artiste?

NQ "Flamuri" ka qenë... unë e kam pasur një kamerë të shtëpisë, dhe nuk ka pasur ndonjë kualitet të lartë. Por, unë mundohesha të ia rregulloj dritën. Ky versioni i punës që prezantohet ka kualitet të ulët të imazhit. Atë që fillimisht e kisha realizuar nuk më pëlqente, nuk kishte impakt, nuk shkonte diçka me të. Në atë version ka qenë edhe më e mirë ngjyra, por nuk më pëlqente. Më pas e kuptova që më pëlqente vrazhdësia e kualitetit të ulët të kamerës së shtëpisë. Fatkeqësisht, tani video ka një kualitet tepër të ulët dhe ai fakt më pikllon, sepse nuk ekziston mundësia të ia ngrisë kualitetin. Njëmend, kur më thoshin atëhere: "Duhesh të fillosh me kualitet të lartë pasi që me kohë të ulet kualiteti dhe të bëhet tamam". Ndërsa unë kam filluar me kualitet të ulët, sepse më pëlqente efekti i kamerës së shtëpisë... si e tillë ka pasur njëfarë ftoftësie.

Për gjeneratën tonë, po, për neve filloi njëfarë interesimi për videon, filloi si medium. Unë me shokët dhe shoqet e mia në shkollë filluam me video, ishim të parët që eksploronim këtë medium. Mirëpo, ka qenë vetëm fillimi, disi ka qenë *in,* ka qenë *hot* të punosh në video.

EK Sa i përket punëve tjera, a ndërlidhen ato mes vete apo kanë një proces të vetin?

NQ Nuk kanë ndonjë ndërlidhshmëri, jo. E vetmja lidhje jam unë, i njëjti trup. Lidhja tjetër është kamera. Unë gjithnjë kam pasur dëshirë ta mbajë kamerën statike edhe subjekti ka qenë aktiv. Subjekti ka bërë diçka, ka përsëritur diçka. Tash në këtë rast, tek "Flamuri" nuk ka përsëritje, por kjo video përcjellë këtë princip të kamerës statike. Në mes të kuadrit është subjekti, është jashtë në errësirë edhe këndon himnin. Domethënë, ajo për mua ka qenë lidhja në mes të kësaj pune dhe tjerave. Kështu që, ndodh kjo lidhje mbetet vetëm në nivel të vizuales.

EK Në çfarë kontekste tjera është prezantuar kjo punë?

NQ Në vitin 2008, "Flamuri" është ekspozuar në *Exception — Contemporary Art Scene from Prishtina* [Përjashtimi-Skena e Artit Bashkëkohor nga Prishtina], një ekspozitë grupore e kuruar nga Vida Knežević, Kristian Lukić, Ivana Marjanović, Gordana Nikolić, në Kontekst Galerija në Beograd dhe Novi Sad. Më vonë ka qenë pjesë edhe e Oktobarski Salon në Beograd, Serbi. *Gender Check. Femininity and Masculinity in the Art of Eastern Europe* [Kontrolli Gjinor. Feminiteti dhe Maskuliniteti në Artin e Evropës Lindore], MUMOK — Museum Moderner Kunst Stiftung Ludwig, Vienë, Austri, nga nëntori i vitit 2009 deri në shkurt të vitit 2010, ekspozitë kjo e kuruar nga Bojana Pejić. Për mua kjo ka qenë një ndër ekspozitat më të rëndësishme, jam ndier shumë krenare. Në vitin 2021 është prezantuar në ekspozitën kolektive të artisteve gra "Synime" e kuruar nga Adela Demetja dhe Erëmirë Krasniqi në Galerinë e Arteve në Tiranë dhe Galerinë e Arteve të Kosovës.

Kjo intervistë është realizuar më 16 shtator, 2023. Intervista është redaktuar dhe kondensuar lehtë për qartësi.









Erëmirë Krasniqi in conversation with Nurhan Qehaja

EK Nurhan, when you produced the single-channel video *The Flag* in 2005, you were living and working in New Zealand, and yet, this work in many ways resonates and is in dialogue with the national identity question that preoccupied Kosovo at that time. Can you discuss in more detail what prompted the making of this work?

NQ I made this video very accidentally. I wanted to take a picture of my feet and I said, "Ah, I want them to move a little." I already had a video of my feet moving like that. That's how I started making videos and bringing my body into my work. I thought the body was... actually the feet were something very interesting, they looked very strange to me, I had long toes and... and I started playing with this fact. Then body-wise, I never liked my body, I never liked anything about my appearance. Later, I found it important to liberate myself from this, to put the body into question, to see what becomes of this body when under scrutiny. But as for the work *The Flag*, something else happened there, since with this work I went rogue, and moved away from my artistic research and took a new direction.

EK In what way?

NQ In a way, it was a moment when I snapped and said I don't care what I have been working on up to this point, and what connection this project might have with the previous works. At that time, I was doing my master's studies and I had a professor with whom I discussed my work. I said to him, "You know what? I'm going to put aside everything that I am currently working on and I want to do this." I went to Majlinda Hoxha's uncle, who was a representative of the Albanian community in New Zealand, and I got the national flag from him. I said to my partner at the time, "Let's go." He drove me. We pulled over at this spot and he turned on the car lights and I sang the national anthem. The anthem is interrupted in the video, but why I interrupted it is a story in itself. The anthem was interrupted because a car was approaching and I got scared. I also stopped shooting. I took the flag and covered my body with it. It was a very funny scene. The car passed and then I shot it one more time because I didn't like the quality of the light. This video was shot outdoors.

EK Outdoors? You can't tell from the video what kind of space it is.

NQ This was at 1:00 in the morning, 1:00 or 2:00 in the morning, something like that. Then I thought, "Let me shoot it one more time, because I don't like the lighting. The lighting is better..." I shot another version of this video, the same one with better lighting, but I didn't like it. When I was in the editing room I said, "No, I like the one with lower-intensity light better," and I cut it there. I said, "I wanna do the reverse." I had used this technique with another video, *Red Tape* (2004). I had experimented with video images by reversing them. And that's how it happened that I started presenting *The Flag* as a video work.

EK Why outdoors when you could have used the school's studio or any other space? Tell me more, why this decision?

NQ My idea had always been to make this video outdoors. Not in the studio, no way! The studio was never an option. I wanted it to be in a space out in the open. Even earlier, I had made other projects outdoors. Those projects took the form of rituals that I performed outdoors and at night. It was a very intuitive decision, not a well thought out decision. No, no, intuitive, I want to sing the anthem here, outside, with a flag, nude. That's it!

EK Can you discuss the use of the body as a vehicle of meaning-making in the video *The Flag*?

NQ When I was in music school, they taught us the national anthem. And the teacher told us, "Look, you learned the anthem, but don't sing it in the street." She was afraid that we would sing it in public. You know how when children learn a song, they want to sing it in the street. And to me it was interesting, because we are somehow raised with this prohibition, "No, hush, hush, hush, hush." When we used to say, "Kosovo Republic! Democracy!" The adults warned us, "Don't you dare say it out loud!" Expressing something related to national identity had consequences, and this was a deep

fear during the Milosević regime in Kosovo of the 1990s.

On the other hand, I grew up with a father who raised us with a lot of shame attached to the body. "No, it's shameful. It's not good!" He looked at you with a critical eye, he didn't tell you directly that something was shameful. I had to understand for myself what was shameful about my actions. But that was his way of thinking that he was protecting us. We were four sisters, so he was worried, "I have to protect them." At that time, while the political situation was tense, he did not allow us to go out of the house much. So, I kind of inherited a lot of things that were not even my problem. I was very young and burdened with these problems. So this has been kind of a burden for me. The restrictions may not have been communicated directly by your father, but you understood from your sisters that certain things were not allowed.

I don't know at what point we start to become self-conscious about our bodies and how we start to feel shame. This happens to many people, but for me it happened at an early age. Somehow I was ashamed, even when my breasts started to show, I was ashamed. Later it manifested itself, by going out nude, singing the anthem and holding the flag.
It was a way for me to counter all these early experiences that instilled in me this feeling of shame.

EK When you produced this work, did you consider yourself a feminist? Can you describe the ease or difficulty of defining yourself as a feminist at that time?

NQ At the time I was like, "Feminism? Meh." I didn't understand — not that I didn't understand, but that that was never the motive. It was never on my radar to talk about it as a feminist work. Not that I had anything against feminism, a lot of my inspiration came from feminist art. When I look back, I followed the work of Marina Abramović, Pipilotti Rist, and many others. There was an exhibition in Auckland about feminist art and I was so drawn to it. Every second day I would go there to see that exhibition. I would take my journal with me and write and just explore each work. So for me, feminist art — even then I didn't see this exhibition as feminist. Even feminist art didn't seem very feminist to me. I apparently had preconceived notions about the term "feminist", which to me meant being bitter and hating men kind of thing. Therefore, I did not identify as such.

EK How did you perceive it?

NQ I was attracted to the journey of a woman who is able to translate the pain and hardship that goes through in an artwork. For me, this aspect has been very meaningful. When a woman survives all the situations she was not allowed to even explore. "You shouldn't, you shouldn't, you shouldn't!" And so many women artists have transcended pre-defined societal limitations through their artistic practice. And to me that was very humbling. And I wanted to be able to do that too. But this desire was not articulated as a conscious decision, like "I want to make feminist art." That was never the motivation I suppose, and that's because I perceived things in a different way. In my artistic research I have been interested in rituals, and a primary aspect has been my spiritual journey. But you can't separate one from the other, because as a woman you have a spiritual journey and you have the grievances of everyday life, but you also have your own story that you have to weave and which is yours alone.

EK Creating your own path as a woman often means undoing a lot of the patriarchy. And this is where I think feminism comes in, it may not come directly from your feminist political stances, but it comes from the experience you go through and what you have to undo to create space for your artistic practice. But can you tell me a little more about how the work was read in Kosovo?

NQ What was read into my work in the Kosovo context, was already present in the reality of this context. That's why I say that this work landed well in this context. More was read into it than I had anticipated. Definitely more. They read into it more than is present in the work, especially the moment in the video where I interrupt the anthem. Which wasn't thought out ahead of time. I already told you the reason why. In a way, it was done willingly, but the reason I decided to have the anthem sung in reverse at the time was an aesthetic decision. I liked how the anthem sounded in reverse.

The way the work was read in Kosovo, I saw it more like... like when a foreigner comes in contact with an ethnic population of a country, but who also tries to understand their own country. That's how I approached it, I was that Kosovar who in a way was separated from the Albanian who had grown up in Kosovo in the '90s, and who had those national sentiments, while I had put that into question as well.

That is why I found the making of *The Flag* interesting, because it also deals with that disconnection from oneself. As a work, it is positioned somewhat from the outside, but it also comes from the inside. However, it's not inside for the reasons for which it was read as inside, definitely not. But, I didn't have much problem with that, because it only contributed to developing other dimensions of the work. And I always found that part interesting.

EK Even though you can't control the meaning of your work.

NQ No, you can't, and it's amazing that you can't do that. As a visual artist, you can't be oblivious to that, you have to be unwise to think, "This is what I want to communicate. Now excuse me, but if you understand it like this, then I am pulling out and do not support your reading." It doesn't work that way. You make something and it lands how it lands. That's how this work landed and it's fine. Maybe I should have emphasized this feminist aspect more, but I couldn't and I don't want to be dishonest about that part.

EK No, no, and I don't expect you to do anything like that.

NQ Yes, I know, that's why we're having this conversation now. But, I'm telling you, I found it a little stressful to articulate it. Somehow I had the impression that people needed to hear this from me, that I had to provide them with such a formulation about my work. Which wasn't the case, and this is my most honest reading.

EK When your work *The Flag* was produced in 2005, the Albanian national flag and the anthem were the main identity signifiers for Kosovo Albanians. This work confronts a version of nationalism through which we conceived national identity before the independence of 2008. After the presentation of this work in Kosovo, what other dimensions has it developed?

NQ I did this work during my master's studies in New Zealand. However, I didn't show it as a work. This work was not presented during my master's studies, because it was not part of my artistic research at that time. That's why, I often say that with this work I went rogue from the research which I had been delving into and was talking about. So, through this work I introduced something completely different. Shortly after graduating in 2006, I came to Kosovo. During that visit I also started to explore the local art scene, but what impressed me was how people saw the work *The Flag* here. When I showed the work to Mehmet Behluli and Shkëlzen Maliqi, and later Erzen Shkololli, they had very high praise for the work, because it communicated well with the local context. Here in Kosovo there was a context for this work. Then I also started thinking about how *The Flag* resonated with the greater themes of this country, such as feminism and nationalism.

EK The camera technology was already more accessible at that point and it was somewhat easier to become a producer of moving images. How developed has video art been in the contexts in which you have worked as an artist?

NQ *The Flag* was... I had a home camera, and it wasn't of any high quality. But I tried to adjust the light. This version of my work that is presented has low image quality. I didn't like what I had originally produced, it had no impact, there was something about it. The color was even better in that initial version, but I didn't like it. Then I realized that I liked the roughness of the home camera's low quality. Unfortunately, now the video is very low quality and it's very sad, because there is no possibility to improve its quality. I remember when I was told back then, "You have to start with high quality so that over time the quality decreases and it becomes just right." Whereas I started with low quality, because I liked the home camera effect... as such it gave it this coldness.

For our generation, yes, for us, some interest in video started, it started as a medium. My friends at school and I started with video work, we were the first ones to start exploring this medium. However, it was only the beginning, somehow it was in, it was hot to work with video.

EK As for the other works, are they interconnected or do they have their own process?

NQ They don't have some kind of connection, no. The only connection is me, the same body. The other connection is the camera. I have always wanted to keep the camera static and the subject dynamic. The subject would always do something, repeat something. Now in this case, in *The Flag* there is no repetition, but this video conveys this principle of the static camera. In the middle of the frame is the subject, she is outside in the dark and singing the anthem. That for me has been the connection between the others and this one. So, this connection happens only at the visual level.

EK In what other contexts was this work presented?

NQ In 2008, *The Flag* was exhibited in *Exception — Contemporary Art Scene from Prishtina*, a group exhibition curated by Vida Knežević, Kristian Lukić, Ivana Marjanović, Gordana Nikolić, at Kontekst Galerija in Belgrade and Novi Sad. Later it was part of *Oktobarski Salon* in Belgrade, Serbia. *Gender Check. Femininity and Masculinity in the Art of Eastern Europe*, MUMOK — Museum Moderner Kunst Stiftung Ludwig, Vienna, Austria, from November 2009 to February 2010, this exhibition was curated by Bojana Pejić. For me, this was one of the most important exhibitions, I felt very proud that it was included. In 2021, it was presented at a survey exhibition of women artists *Ambitions* curated by Adela Demetja and Erëmirë Krasniqi at the National Gallery of Arts in Tirana, Albania and Kosovo National Gallery in Prishtina.

This interview was conducted on September 16th, 2023. It has been lightly edited and condensed for clarity.

Histori e dendur: përballja me trashëgimitë e kombit

Lara Fresko-Madra

"Në Paraburgim" e Esra Ersen (1995) është një instalacion i thjeshtë por kërcënues me lidhëse këpucësh të lidhura si lak, të varura në të dyja anët e një korridori me ndriçim fluoreshent. Madje edhe të shikosh një imazh të tijin shkakton një klaustrofobi që vie në shprehje jo vetëm për shkak të përsëritjes së pafundme në dukje të paternave përbrenda hapësirës së mbyllur të tunelit, por edhe nga mjedisi burokratik dhe dizajni i ndriçimit. Njëmend, deri më sot ende nuk ka pasur një përmbyllje të këtij momenti historik që Ersen po shënonte përmes kësaj pune artistike, kur zhdukjet e dhunshme nën kushte të paraburgimit ishin bërë një çështje e zakonshme dhe një simptomë e përshkallëzimit të luftës civile paraushtarake të shtetit kundër lëvizjes kurde.

Dhuna shtetërore është tinëzare në rutinën e saj dhe sa më shumë që ka jetëgjatësi, aq më shumë bëhet normë. Shpesh është legjitimuar diskursivisht, duke u fshehur pas fjalëve si terrorizmi, mbrojtja, sovraniteti. Pasojat, të cilat do të ndjehen ndër breza, ndrydhen në procesin e të menduarit si një ngarkesë e domosdoshme e operacioneve të kombit, një akt i përditshëm sikur mbyllja e derës kur del nga shtëpia, diçka aq rutinore saqë harrohet. E megjithatë implikimet e saj janë të gjata, kumbuese dhe gjithëpërfshirëse.

Përballë një dhune të tillë rutinore, rezistenca fillon duke i bërë pasojat e saj fizike dhe emocionale të prekshme, të pazakonta dhe të vazhdueshme. Aty ku njerëzit zhduken, dikush duhet të *paraqitet* për të u interesuar për ta. Që nga viti 1995, çdo të shtunë, ndërsa *Saturday Mothers* [Nënat e të Shtunave] mblidhen për të u ulur në pritje të të dashurve të tyre të humbur, në mënyrë paqësore, të palëkundura, ato ngacmohen, brutalizohen dhe merren në paraburgim nga një forcë policore e pamëshrishme. Ndërsa syri i mendjes sonë i grumbullon këto imazhe të sulmeve përgjatë një vëzhgimi të thjeshtë, javë pas jave, muaj pas muaji, vit pas viti, puna e Ersen vazhdon të kumbojë, sikur ne po vazhdojmë të ecim në atë korridor klaustrofobik ogurzi.

Ndjeshmëria e së shkuarës, e cila gjithmonë përndjek të tashmen, ka definuar hapësirën kulturore në Turqi që nga fundi i viteve 1980, një moment kur politika ekonomike neoliberale dhe lufta nacionaliste paramilitare u bashkëdyzuan. Ndoshta jo rastësisht, ky ishte gjithashtu fillimi i kthesës globaliste në artin bashkëkohor, i shënuar në nivel lokal nga institucioni i Bienales Ndërkombëtare të Stambollit në 1987. Nurdan Gürbilek kishte shkruar për vitet 1980 si një "periudhë mohimi, censurimi dhe heshtjeje; por gjithashtu një premtim, që provokon dëshirën si kurrë më parë"[1]. Konfuzioni që vinte nga ato që dukeshin si kontradikta — liberalizmi dhe militarizmi, multikulturalizmi dhe nacionalizmi — ofruan terren pjellor që praktika artistike të i përgjigjet jo vetëm drejtpërdrejt dhe menjëherë, por në mënyrë heterokronike dhe të tërthortë. Kjo do të thotë, duke iu qasur historisë përmes një thjerrëze bashkëkohore dhe të tashmes përmes një thjerrëze historike. Pikë referuese e menjëhershme e instalacionit të Ersen mund të ketë qenë mohimi me të cilin iu vërsulën kurdëve dhe majtistëve në atë kohë, megjithatë fillimet e viteve 1990 karakterizoheshin me fantazmat e kombit që nga fillimi i tij shtatë dekada më parë.

Dekadat që pasuan nuk ishin më pak të përshkuara nga kontradikta të tilla. Vazhdimësia dhe shkëputja ekzistojnë krah për krah përgjatë shekullit që tani është shënuar nga Republika. Në përgjithësi, vitet midis 1990 dhe ditës së sotme kanë qenë dëshmitare të përshkallëzimit të dinamikave të tilla komplekse të shtypjes dhe kthimeve të tyre, që datojnë nga themelimi i Republikës së Turqisë në vitin 1923 në territoret qendrore të Perandorisë Osmane. Megjithatë, tranzicioni nga Perandoria në Republikë, i cili është regjistruar në historinë zyrtare si viti zero, shkëputja përfundimtare, në mënyrë të përshtatshme dëmton dhe errëson përfytyrimet e tilla afatgjata. Në fakt, ndoshta më e rëndësishmja, një shkëputje e tillë mohon përfshirjen në Gjenocidin Armen të vitit 1915[2]. Dhuna, megjithatë, nuk mund të rregullohet nga përpjekje të tilla periodizuese. Në të vërtetë, jo vetëm që viti 1915 vazhdon të përndjekë gjeografinë, por dhuna shtetërore ka vazhduar të vërshojë frontet demografike, kulturore, gjuhësore dhe ekonomike. Episodet dhe ngjarjet përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm te: shkëmbimi i popullsisë greke [Mübadele] i vitit 1924, taksa e

1
Gürbilek, N. (2011). *The New Cultural Climate in Turkey: Living in a Shop Window* [Klima e Re Kulturore në Turqi: Të Jetosh në një Dritare Dyqani]. Shtëpia boruese Zed Books.

2
Fatma Müge Göçek gjurmon dinamikën e dhunës etnike kundër armenëve që nga fundi i shekullit të 18-të. Për më shumë, shihni: Göçek, F. M. (2015). *Denial of Violence: Ottoman Past, Turkish Present and Collective Violence against the Armenians*, 1789-2009 [Mohimi i Dhunës: E Kaluara Osmane, e Tashmja Turke dhe Dhuna Kolektive kundër Armenëve, 1789-2009]. Oxford University Press.

pasurisë [Varlık Vergisi] mbi pakicat jomuslimane në vitin 1942, pogromi i Stambollit kundër komuniteteve greke (Rum) dhe pakicave të tjera në vitin 1955, një tjetër valë dëbimi të grekëve (Rum) në vitin 1964, pogromet kundër komuniteteve Alevi që përfshijnë masakrat e Maraş në vitin 1978 dhe djegien e Hotelit Madımak në vitin 1993, si dhe lufta e vazhdueshme e shtetit kundër komuniteteve kurde të Turqisë në katër dekadat e fundit. Këto janë vetëm disa nga ngjarjet që kristalizojnë dhunën që përbën përfytyrimin kombëtar. Dhe megjithëse lista në instalacionin e Ersen na kujton strukturën e përsëritjes, rezonanca e saj afektive e tejkalon çdo lidhëse këpucësh të lidhur si lak dhe madje edhe shumën e tyre të përgjithëshme.

Trilogjia e video punës së Ersen zgjeron tutje fushën e citimeve ndaj modernizmit letrar që përbëjnë një politikë identitare të projektit të ndërtimit të kombit. Në "Një Histori e Mundshme I: Kur Mendojmë se Disa Luajnë me Mustaqe, të Tjerët Kryqëzojnë Krahët" (2013) Ersen udhëton për në Sofje në Bullgari, duke ndjekur rrugën e Yahya Kemal, udhëpërshkrues, autor, intelektual dhe përfaqësues i hershëm republikan i shtetit. Videoja përbëhet nga imazhe të gjetura dhe të vendosura në libër të shënimeve, shkarravitje, tituj, suvenire nga udhëtimi, ndërsa zëri i narracionit mediton mbi modernizimin në fund të Perandorisë Osmane dhe krizën e pashtershme civilizuese në të cilën territoret e saj të mëparshme kishin rënë pas shuarjes së saj. Ajo lexon nga libra të ndryshëm që gjen, si një libër të mirësjelljes dhe një katalog që gjen ditën e parë të saj në të cilin shkruan: "Imazhet artistike të burrit, gruas dhe fëmijës luajnë një rol të rëndësishëm në modernizimin simbolik të shoqërisë në Bullgari".

Ajo vazhdon, duke folur për ngjashmëritë dhe dallimet midis arkitekturës dhe mënyrës se si njerëzit kompozohen brenda Sofjes dhe Ankarasë, se si secila lidhet me të qenit orientale apo oksidentale: as njëra, as tjetra, jo më, akoma jo. Me krahasimin që Yahya Kemal ia kishte bërë strukturës së qytetit si rrjet me një qytet amerikan, kishte sugjeruar se ai qytet është ndoshta shumë modern, jo mjaftueshëm evropian, dhe këtu Ersen merr rast për të tërhequr një paralele që ndërlikon shpërndarjen gjeografike të modernitetit që shpesh vendoset në aksin Lindje-Perëndim. "Për E, megjithatë, vjen në mendje një qytet më në lindje, Ankaraja, vendi i saj i lindjes. Në vitin 1921, Yahya Kemal shkroi se Sofja kishte një fasadë të re evropiane, e cila kryesisht përbëhej nga një koleksion arkitekture pa karakter, dhe se ishte një qytet pa histori dhe pa shpirt".

Në "Një Histori e Mundshme II: Heronjë Turk, Stoli Kineze" (2015), zëri i narracionit i jepet një burri me theks britanik ndërsa estetika e kolazhit vazhdon të lëvizë mes shënimeve kërkimore dhe novelave grafike. Në kontekstin e një muzeu, institucioni qytetërues *par excellence*, zëri i narracionit prezanton baballarët themelues të kombit aktual — duke u zgjeruar në mënyrë të pamëshirshme, ekstraktuese, fantastike në histori deri tek Mete Han, i cili sundoi rrafshnaltën mongole në shekullin e III-të p.e.s. Oficeri bashkëkohor dhe një ushtar Hun shfaqen në të njëjtën faqe fletoreje me vija, të lidhur me një kabllo telefoni të dredhuar, narracioni u jep zë mendimeve të E, me gjasë të vetë artistes: "Ajo mbylli sytë për një çast dhe imagjinoi oficerin duke folur me një ushtar Hun në telefon. E kaluara, me të jemi të lidhur përmes kordonit të kërthizës, murmuriti ajo". Kështu, puna e Ersen karikaturizon në mënyrë kritike përfytyrimin e shtetit-komb dhe kornizave kohore që lidhen me etninë që legjitimojnë ekzistencën e tyre, si dhe kapin jehonat e vazhdimësive të tilla nëpër histori të ndryshme kombëtare.

Temporaliteti i ngadaltë dhe natyra e shpërndarë e një dhune të tillë konstituive, epistemike e bën të vështirë përkushtimin ndaj historisë, të prezantimit vizual ose narrativizimit të saj[3]. Në vitet 1990, dinamika komplekse e vazhdimësisë midis momenteve, epokave dhe proceseve të ndryshme të dhunës historike arritën kulmin. Debati thellë i rrënjosur, që rrjedh nga përfytyrimet divergjente të historive të origjinës së Turqisë — nëse trashëgimia dhe rrënjët e saj u kthyen në Azinë Qendrore apo nëse Perandoria Osmane shumëetnike u faktorizua në përfytyrimin kombëtar që Turqia do të përqafonte — ngriti pyetje se ku kishte shkuar diversiteti dhe kur dhe pse?

"Unë Njoh Njerëz të Tillë II" (1992) nga Hale Tenger, një instalacion muri i përmasave të mëdha, paraqet një heterotopi të shumëfishtë simbolesh. Nga larg, mund të jetë thjesht një qiell i mbushur me yje me një gjysëmhënë. Një audiencë lokale, me gjasë, menjëherë do të përvetësonte qiellin e natës në mitologjinë e tyre kombëtare. Një vështrim më i afërt i punës zbulon më pas dy simbole të tjera që përbëjnë gjysëmhënën dhe yjet: Figurina të vogla prej bronzi të tre majmunëve të mençur — që nuk shohin të keqen, nuk dëgjojnë të keqen dhe nuk flasin keq — dhe njeriun me penisin e madh — një trope kulturor që shpesh i atribuohet perëndisë greke të fertilitetit, Priapus. Kjo lojë me përmasa ka një efekt tronditës që e zhvendos kuptimin e kësaj pune nga një reprezentim i lexueshëm, qoftë i qiellit apo i një flamuri, në një kritikë në dukje që zgjon polemika të menjëhershme por gjithashtu e vështirë për të u deshifruar plotësisht. Me të vërtetë, dy figurat vijnë nga filozofia Lindore dhe mitologjia greke respektivisht, dhe secila ka një funksion reprezentues të menjëhershëm, si dhe një histori më të thellë që mund të kontradiktojë atë interpretim fillestar.

Kjo punë, e ekspozuar në edicionin e tretë të Bienales së Stambollit, e kuruar nga Vasıf Kortun, shpesh është zhytur në kontekstin e saj lokal për shkak të pengesave ligjore. Është treguese që kjo punë ka arritur në gjykata dhe akuzuar për ofendim të flamurit kombëtar. Ndoshta edhe më treguese është që Tenger u shpall e pafajshme për shkak të mbrojtjes së saj, që thonte se puna nuk kishte të bënte me kombin apo flamurin, por më tepër ishte kritikë e dhunës mashkullore[4]. Artistja me gjasë nuk kishte planifikuar të mobilizonte errësirën dhe paqartësinë e këtyre mitologjive në një mbrojtje ligjore.

Këtu, ne gjithashtu duhet të marrim parasysh edhe "Në Paraburgim" nga Ersen dhe "Unë Njoh Njerëz të Tillë II" nga Tenger në kontekstin e kthesës globale në fillim të viteve 1990. Në esenë e saj të titulluar "Bota në Pamje të Drejtpërdrejt: Forma në Shërbim të Globalës", Joan Kee shkruan për një dilemë me të cilën përballet artistja jo-euro-amerikane: "Nëse një lloj specifik ikonografie të nivelit të ulët është me të vërtetë gjithçka që pritet, pse të mos përmbushen këto pritshmëri me një hakmarrje?"[5] Loja e Tenger me shkallët e perceptimit përfshin sigurisht këtë ikonografi të nivelit të ulët në mobilizimin e qiellit të natës të kthyer në flamurin turk. E megjithatë, hakmarrja duket të jetë në atë që Tenger, duke e bërë këtë, nuk po tradhton identitetin e saj në kuptimin kombëtar, por në fakt pozicionin e saj si një intelektuale dhe kritikuese e atij identiteti etnik që presupozohet të jetë i saj. Si Ersen ashtu edhe Tenger punojnë pikërisht me një shkallë paqartësie që e paracakton punën e tyre për të operuar brenda estetikës së konceptualizmit global.

Paqartësia ka një veprim tre-pjesësh si një forcë gjeneruese në punën e tyre. Së pari si një mënyrë e mundshme vetëcensurimi pasi dolën nga errësira e dekadës së pas grusht shtetit të vitit 1980. Së dyti, si njohje e asaj që, në fillim të viteve 1990 për një moment u hoqën (ndryshuan në formë) dënimet e rënda ligjore mbi fjalën e lirë politike që kishte përshkuar vitet 1980, megjithëse infrastruktura e nacionalizmit vetëasgjësues mbeti gjallë dhe mirë. Dhe së fundi, dhe jo pa pasur një ndërlidhshmëri, si një paqartësi që kufizohet me abstraksionin, që e hap punën e tyre drejt një signifikimi (global) heterokronik dhe ndërgjeografik. Pra, këto punë janë në gjendje të durojnë dinamikën e larmishme por strukturalisht të ngjashme socio-politike të momenteve të ndryshme të prezantimit të tyre dhe të bëhen të ndjeshme brenda atyre momenteve.

3
Sfida përfaqësuese e paraqitur nga shpërndarja kohore e ngadalësisë rrjedh nga teoria e Rob Nixon për dhunën e ngadaltë. Për më shumë, shihni: Nixon, R. (2011). *Slow Violence and the Environmentalism of the Poor* [Dhuna e Ngadaltë dhe Ambientalizmi i të Varfërve]. Shtëpia boruese Harvard University Press.

4
Interpretimi i Ahu Antmen mbi punën artistike merret seriozisht nga mbrojtja ligjore dhe pretendimi i saj se kjo është një punë që trajton dhunën hetero-patriarkale.

5
Kee, J. (2013). The World in Plain View: Form in the Service of the Global [Bota në Pamje të Drejtpërdrejt: Forma në Shërbim të Globalit]. Në A. Dumbadze dhe S. Hudson (Red.), *Contemporary Art: 1989 to the Present* [Arti Bashkëkohor: 1989 deri më sot]. Wiley-Blackwell, 98.

Overwhelming History: Tackling the Legacies of the Nation

Lara Fresko-Madra

Esra Ersen's *Under Custody* (1995) is a simple yet menacing installation of shoelaces tied in nooses, hung on either side of a fluorescent-lit corridor. Even looking at an image of it induces a claustrophobia that is derived not only from the seemingly endless repetition of the pattern within the spatial confinement of the tunnel-like space but also its bureaucratic surround and lighting. Indeed, to this day there has still been no end to the historical moment that Ersen was marking with this work, when forced disappearances under custody had become a household topic and a symptom of the state's escalating paramilitary civil war against the Kurdish movement.

State violence is insidious in its routineness, and the longer its duration, the more ambient it becomes. It is often legitimized discursively, hiding behind words like terrorism, defense, or sovereignty. The consequences, which will last generations, are repressed in thought processes as a necessary overhead in the nation's operations, an every-day act like locking the door as you leave, something so routine that it is forgettable. And yet its implications are long lasting, resonant, and encompassing.

In the face of such rote violence, resistance begins with making its physical and affective consequences tangible, out of the ordinary, and persistent. Where people are disappeared, one must *appear* to ask after them. Since 1995, each Saturday, as the Saturday Mothers gather to sit in wait for their lost loved ones, peacefully, adamantly, they are harassed, brutalized, and taken under custody by a ruthless police force. As our mind's eye accumulates these assaults on a simple sit-in, week after week, month after month, year after year, Ersen's work continues to resonate, as if we are continuing to walk in that claustrophobic, ominous corridor.

The sensibility of the past ever haunting the present has defined the cultural space in Turkey since the late 1980s, a moment when neoliberal economic policy and nationalist paramilitary warfare converged. Perhaps not coincidentally, this was also the inception of the globalist turn in contemporary art, marked locally by the institution of the Istanbul Biennial in 1987. Nurdan Gürbilek had famously written of the 1980s as a "period of denial, censorship, and silencing; but also one of promise, provoking desire as never before."[1] The confusion that stemmed from what seemed like contradictions — liberalism and militarism, multiculturalism and nationalism — offered fertile ground for artistic practice to respond not only directly and immediately, but heterochronically and obliquely. That is, by approaching history through a contemporary lens and the present through a historical lens. The immediate point of reference of Ersen's installation may have been denial unleashed towards Kurds and leftists at the time, yet the early 1990's were also teeming with ghosts of the nation since its inception seven decades prior.

The following decades were no less riven with such contradictions. Continuity and rupture exist side by side across the century that has now been marked by the Republic. Broadly, the years between 1990 and today have witnessed the escalations of such complex dynamics of repression and their returns, reaching back to the foundations of the Republic of Turkey in 1923 on the central territories of the Ottoman Empire. However, the transition from Empire to Republic, which is recorded in official history as year zero, the ultimate rupture, conveniently impairs and occludes such *long durée* imaginaries. Indeed, perhaps most importantly such rupture disowns implication in the Armenian Genocide of 1915.[2] Violence, however, cannot be contained by such efforts of periodization. Indeed, not only has 1915 continued to haunt the geography but state violence has continued to cascade in demographic, cultural, linguistic, and economic fronts. Episodes and events include but are not limited to: the Greek population exchange [*Mübadele*] of 1924, the Wealth Tax [*Varlık Vergisi*] on non-Muslim minorities in 1942, the Istanbul Pogrom against the Greek (Rum)

1
Gürbilek, N. (2011). *The New Cultural Climate in Turkey: Living in a Shop Window*. Zed Books.

2
Fatma Müge Göçek traces the dynamics of ethnic violence against Armenians back to the late 18th century. For more, see: Göçek, F. M. (2015). *Denial of Violence: Ottoman Past, Turkish Present and Collective Violence against the Armenians, 1789–2009*. Oxford University Press.

and other minority communities of 1955, another wave of Greek (Rum) expulsion in 1964, pogroms against the Alevi communities that include the 1978 Maraş massacres and the burning down of the Madımak Hotel in 1993, as well as the ongoing war waged by the state against the Kurdish communities of Turkey in the past four decades. These are but a few events that crystallize the violence that constitute the national imaginary. And though the list recalls the structure of repetition in Ersen's installation, its affective resonance exceeds that of each shoelace tied into a noose, or even the sum total of them.

Ersen's trilogy of video-works further expands the field of citations to literary modernism that constitute an identity-politic of the nation building project. In *A Possible History I: When Thinking Some Play with the Mustache, Others Cross Arms* (2013) Ersen journeys to Sofia in Bulgaria, following the route of Yahya Kemal, the author, intellectual, and early Republican State Representative. The video consists of found images placed on notepad paper, scribbles, titles, and souvenirs from the journey, while the voiceover ruminates about modernization at the end of the Ottoman Empire and the inexhaustible civilizational crisis its former territories fell into upon its demise. She reads from various books she finds, such as a book of etiquette and a catalog she finds on the first day which reads: "Art images of man, woman and child play a significant role in the symbolic modernization of society in Bulgaria."

She continues, talking about the similarities and differences between the architecture and the way people compose themselves within Sofia and Ankara, how each relates to being oriental or occidental: neither, nor, no longer, not yet. Upon Yahya Kemal's comparison of the grid structure of the city to an American town, suggesting that it is perhaps too modern, which is to say, not European enough, Ersen seizes the opportunity to draw a parallel that complicates the geographical distribution of modernity that is often placed on an East-West axis. "For E, however, a city further east comes to mind, Ankara, her place of birth. In 1921, Yahya Kemal wrote that Sofia had a new European façade, which chiefly consisted of a collection of bland architecture, and that it was a city without a history and without a soul."

In *A Possible History II: Turkish Heroes, Chinese Knick Knacks* (2015), the voice-over is given over to a man with a British accent as the collage aesthetic continues to toggle between research notes and graphic novels. In the context of a museum, the civilizational institution *par excellance*, the voice-over introduces the founding fathers of the current nation — ruthlessly, extractively, fantastically expanding into history all the way back to Mete Han, who ruled the Mongolian plateau in the 3rd century BCE. The contemporary officer and a Hun soldier appear on the same ruled notebook page, connected by a curly phone cord, the voiceover narrates the thoughts of E, likely the artist herself: "She closed her eyes for an instant and imagined the officer talking to a Hun soldier on the phone. The past, we're connected to with umbilical cords, she murmured." Ersen's work thus critically caricaturizes the nation-state's imaginary of ethnically bound timelines that legitimate their existence as well as capturing the echoes of such continuities across distinct national histories.

The slow temporality and dispersed nature of such constitutive, epistemic violence makes it difficult to commit it to history, represent it visually, or narrativize it.[3] In the 1990s, the complex dynamics of continuity between different moments, eras, and processes of historical violence came to a head. The deep-seated debate, stemming from divergent imaginaries of Turkey's origin stories — whether its heritage and roots went back to central Asia or whether the multi-ethnic Ottoman Empire factored into the national imaginary that Turkey would subsequently embrace — brought up questions about where the diversity had gone, and when and why?

Hale Tenger's *I Know People Like This II* (1992) a grand wall installation, presents a multiscale heterotopia of symbols. From afar, it may merely be a star-studded sky with a crescent moon. A local audience, however, would likely appropriate the night sky immediately into their national mythology. A closer viewing of the work then reveals two further symbols that constitute the crescent and stars: Small, cast-brass figurines of the three wise monkeys — who see no evil, hear no evil, and speak no evil — and the man with the big penis — a cultural trope often attributed to the Greek god of fertility, Priapus. This shift in scale has a jarring effect that moves the signification of the piece from a legible representation, whether of the sky or a flag, to a seeming critique that is immediately polemical and yet also hard to fully decipher. Indeed, the two figurines hail from Eastern philosophy and Greek mythology respectively, and each has both an immediate representative function as well as a deeper story that may contradict that initial interpretation.

